

RAPORT:
**“VLERËSIMI I FUNKSIONIMIT TË
STRUKTURAVE KUNDËR DHUNËS NË
FAMILJE NË POLICINË E SHTETIT,
SI PJESË E MEKANIZMIT TË
REFERIMIT DHE TRAJTIMIT TË
RASTEVE TË DHUNËS NË
MARRDHËNIET FAMILJARE”**

Korrik 2015



RAPORT:
**“VLERËSIMI I FUNKSIONIMIT TË STRUKTURAVE KUNDËR
DHUNËS NË FAMILJE NË POLICINË E SHTETIT, SI PJESË E
MEKANIZMIT TË REFERIMIT DHE TRAJTIMIT TË RASTEVE TË
DHUNËS NË MARRDHËNIET FAMILJARE”**

Eksperte:

MSc. Monika Kocaqi (Doktorante në proçes)
MSc. Miranda Fishka (Doktorante në proçes)

Grupi konsultues

Drejtues Silvana Alimadhi – Policia e Shtetit
Z. Robert Korkuti – Drejtor i SACP

@ Programi “Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme/Policisë
së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet”

Tiranë, Korrik 2015

Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij raporti për qëllime përfitimi

Ky raport vlerësimi u hartua për t’u ardhur në ndihmë punonjësve të Policisë së Shtetit Shqiptar në kuadër të hapave që do të ndërmerren për aplikimin e filozofisë së policimit në komunitet, si një strukturë ndihmëse edhe për trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare, në vijim të përgjegjësive që ka Policia e Shtetit si antare e Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të këtyre rasteve.

Mendimet dhe pikpamjet e shprehura në këtë vlerësim janë të autoreve dhe jo detyrimisht shprehin opinionin e vetë Programit “Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme/Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet”.

FALENDERIME

Programi SACP “Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme/Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet” si dhe autoret e këtij raporti, dëshirojnë të shprehin mirënjohjen dhe falenderimet e tyre për të gjitha institucionet dhe individët e përfshirë në dhënien e informacionit për realizimin e këtij vlerësimi.

Falenderime të singerta u përcillen të gjithë institucioneve që pa hezitim vunë në dispozicion përfaqësueset(it) apo punonjëset(it) e tyre për dhënien e informacionit dhe përfshirjen në intervista të thelluara apo diskutime në grupe të fokusuara (lista e detajuar me emrat përkatës gjendet bashkëlidhur këtij raporti), të tillë si: Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Policisë së Qarkut në Tiranë, Shkodër dhe Elbasan, Prokuroria e Rrethit në Shkodër dhe Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor në Shkodër dhe Elbasan, Instituti i Mjekësisë Ligjore në Tiranë, Akademia e Sigurisë në Tiranë, Zyrat e Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje në Bashkitë Tiranë, Shkodër dhe Elbasan, Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Dhunës në Familje, si dhe Qendra Komunitare “Sot për të Ardhmen”.

Falenderime të veçanta u përcillen edhe të gjithë profesionisteve(ëve) dhe institucioneve që u përfshinë në fazën e konsultimit për vlerësimin e gjetjeve të pasqyruara në këtë raport.

Së fundi, por jo nga rëndësia, falenderojmë znj. Silvana Alimadhi, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe z. Robert Korkuti, Drejtor Projekti SACP, për mbështetjen dhe kontributin e veçantë në të gjithë hapat e zhvillimit të këtij vlerësimi, si dhe për mendimet e vlefshme mbi strukturën dhe përmbajtjen e raportit.

Shpresojmë që ky vlerësim do të jetë sadopak ndihmues dhe orientues për vijimin e punës së punonjësve të policisë si antarë të Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare, si dhe do të shërbejë si udhëzues për planifikimin dhe hedhjen e hapave të mëtejshëm në të ardhmen, kryesisht në funksion të zbatimit në praktikë të filozofisë së policimit në komunitet.

SHKURTIME

DPQ	-	Drejtoria e Policisë së Qarkut
DPP	-	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DHF	-	Dhuna në Familje
KP	-	Komisariati i Policisë
LDHF	-	Ligji nr. 9669 dt.18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrdhëniet Familjare”
MAS	-	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MD	-	Ministria e Drejtësisë
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
MMSR	-	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
MSH	-	Ministria e Shëndetësisë
OJF	-	Organizata Jo-Fitimprurëse
OPK	-	Oficer i Policimit në Komunitet
PK	-	Policimi në Komunitet
PP	-	Patrulla e Përgjithshme
SPZ	-	Specialist i Policisë në Zonë (shërbim i ndihmës)
ZSHQ	-	Zyra e Shërbimit për Qytetarët
PSH	-	Policia e Shtetit
PSHSH	-	Policia e Shtetit Shqiptar
QSH	-	Qeveria e Shqipërisë
SACP	-	Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj MPB/PSH për policimin në komunitet.

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME	4
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
II. HYRJE.....	12
III. METODOLOGJIA.....	14
IV. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.	16
<i>IV/a. Përkufizimi i fenomenit.....</i>	<i>16</i>
<i>IV/b. Të dhënat statistikore.....</i>	<i>18</i>
<i>IV/c. Kuadri ligjor.....</i>	<i>21</i>
<i>IV.d. Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare.....</i>	<i>23</i>
<i>IV/e. Modeli i policimit në komunitet.....</i>	<i>25</i>
V. ANALIZA E TË DHËNAVE	27
<i>V/a. Strukturat dhe specialistet(ët) e angazhuar në trajtimin e rasteve.....</i>	<i>27</i>
<i>V/b. Gjetjet nga analiza e të dhënave sipas rretheve.</i>	<i>31</i>
V/b.1. TIRANË.....	31
V/b.2. SHKODËR	33
V/b.3. ELBASAN	36
<i>V/c. Opinion i përgjithshëm i punonjësve të policisë mbi riorganizimin e rolit, funksioneve dhe strukturës së policimit në komunitet.....</i>	<i>37</i>
VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	40
VII. ANEKSE.....	45
<i>VII/a. Lista e të intervistuarve dhe pjesëmarrësve në grupet e fokusuara.....</i>	<i>45</i>
<i>VII/b. Struktura e intervistës</i>	<i>47</i>
<i>VII/c. Struktura e grupeve të fokusuara</i>	<i>48</i>
VIII. BIBLIOGRAFI	49

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti në vijim paraqet një përmbledhje të gjetjeve kryesore nga vlerësimi i strukturave kundër dhunës në familje në Policinë e Shtetit Shqiptar, në kuadër të përgjegjësiqve që ka kjo e fundit si antare e Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare. Gjatë vlerësimit është marrë në konsideratë edhe aplikimi i mëtejshëm i filozofisë së policimit në komunitet, sikundër parashikohet dhe në “Strategjinë e Policimit për Sigurinë në Komunitet 2015-2017”, hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me asistencën e SACP - Mbështetja e Qeverisë Suedeze për MPB/PSH për policimin në komunitet¹.

Vlerësimi u realizua bazuar në metodologjinë e miratuar nga SACP që përmbante si analizë të dokumentave të hartuara më parë ashtu edhe intervista të thelluara me profesionistë të ndryshëm, apo diskutim në grupe të fokusuara me përfaqësues(e) të Policisë së Shtetit. Të dhënat u mbledhën në tre qarqe: Tiranë, Shkodër dhe Elbasan².

Gjetjet kryesore nga ky vlerësim na orientojnë drejt dhënies së disa rekomandimeve³, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në vijim:

- **Organizimi dhe struktura në Policinë e Shtetit** – sipas organogramës së Policisë së Shtetit⁴ trajtimi i rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare mbulohet nga Sektori për të Miturit dhe Dhunën në Familje, i Drejtorisë për Krimet, në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ky Sektor përbëhet nga një shefe dhe dy specialiste, ndërsa në nivel të Drejtorisë së Policisë së Qarkut, në Tiranë ekziston Seksioni për të Miturit dhe Dhunën në Familje me dy specialiste, kurse në rrethe ka vetëm një Specialist(e) për të Miturit dhe Dhunën në Familje. Me qëllim përmirësimit e efektivitetit të PSH si antare e Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare, si dhe nisur nga fakti që kjo strukturë konsiderohet një hallkë kyçe brenda Ekipit Teknik Ndërdisciplinar të këtij Mekanizmi, sugjerohet:
a) Fuqizimi i sektorit ekzistues (duke e mbështetur me burimet e nevojshme njerëzore⁵, financiare dhe infrastrukturore), në përshtatje edhe me ndryshimet që priten të ndodhin brenda strukturës së përgjithshme të Policisë së Shtetit, por duke marrë në konsideratë dhe reflektuar në mënyrën më të mirë të mundshme veçoritë dhe standartet respektive kombëtare e ndërkombëtare, për ndërhyrjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare.
b) Përmirësimi i metodave të monitorimit të brendshëm dhe ndarjes së informacionit, veçanërisht për mbledhjen e ankesave dhe pengesave të

¹ Konsultuar versioni i Shkurtit 2015 – vënë në dispozicion në 15.06.2015

² Një përshkrim më i detajuar i metodologjisë është dhënë në seksionin me të njëjtin titull të këtij raporti.

³ Rekomandimet e detajuara përshkruhen në kapitullin përkatës me të njëjtin titull, të këtij raport vlerësimi

⁴ Nr.231 Prot, datë 12.05.2015

⁵ Nga të intervistuarat(it) u sugjerua që në komisaritet e nivelit të parë dhe të dytë të ketë të paktën një specialist të nivelit bazë - nënkomisar. Po kështu, u rekomandua fuqishëm edhe përfshirja e specialisteve gra.

hasura për plotësimin e nevojave të viktimave rast pas rasti. Ky informacion është tepër i rëndësishëm dhe i duhet përcjellë vazhdimisht e në mënyrë protokollare Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare. Njëkohësisht, në cilësinë e antarit të këtij Mekanizmi, përfaqësueset(it) respektivë të PSH që marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit Drejtues, duhet të kërkojnë rregullisht edhe ndarjen e informacionit mbi performancën e institucioneve, *kuptohet duke respektuar paraprakisht detyrimin e tyre ligjor sipas VKM nr.334/2011 për përcjelljen e rregullt të informacionit tek Koordinatori(ja) Vendor(e), në lidhje me numrin e rasteve të trajtuara nga PSH.* Tashmë ekziston lehtësisht mundësia për vlerësimin e kësaj performance institucionale përmes sistemit elektronik të mbledhjes së të dhënave për trajtimin multidisiplinar të rasteve të dhunës në familje, sistem ky i instaluar në çdo bashki të vendit⁶ në të cilin ka akses edhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Megjithatë, siç u kërkuar për PSH, në mënyrë që të analizohet performanca institucionale, duhet që *çdo institucion të përcjellë të dhënat për rastet në kohë dhe në mënyrë të rregullt, sipas detyrimit që ka bazuar në VKM 334/2011.* Analiza të tilla të përbashkëta të punës së kryer dhe hapave të ndërmarrë, do të çojnë rrjedhimisht në diskutime specifike dhe gjetjen e zgjidhjeve afatgjata e të qëndrueshme.

- ***Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve*** – *Pavarësisht trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera edukuese e informuese të realizuara ndër vite nga aktorë të ndryshëm në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, sërish mbetet evidente nevoja për vazhdimin e ndërhyrjeve në këtë drejtim. Qarkullimi i punonjësve nga një sektor në tjetrin apo nga një Drejtori e Policisë së Qarkut në tjetrën⁷, emërimi i punonjësve të rinj, si dhe mbështetja për trajtimin e rasteve të dhunës në familje edhe nga struktura të tjera të policisë (si Patrulla e Përgjithshme apo Specialisti i Policisë në Zonë) duhet të shoqërohen domosdoshmërisht me aktivitete për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të këtyre punonjësve, për të trajtuar me efektivitet e përgjegjshmëri rastet e dhunës në marrdhëniet familjare. Po kështu fuqizimi i Mekanizmit të Referimit dhe shtrirja e tij në të gjithë vendin, gjithashtu kërkon dhe organizmin e trajnimeve të punonjësve të policisë kryesisht në drejtim të bashkëveprimit dhe ndarjes së detyrimeve e përgjegjësi si antarë të këtij Mekanizmi. Ky rekomandim do të ishte akoma edhe më i efektshëm nëse paraprihet nga këto dy hapa:*
- a) Krijimi i një baze të dhënash të detajuar e të përditësuara ku të pasqyrohen qartësisht kapacitetet ekzistuese, lëvizjet e tyre brenda strukturave të policisë, si edhe aktivitetet për përmirësimin e aftësive profesionale në të cilat mund të jenë përfshirë (trajnime, seminare, vizita studimore, etj). Kjo bazë të dhënash mund të ngrihet bazuar mbi atë aktualen⁸, por duke ndërmarrë paralelisht edhe një proces vlerësimi me fokus

⁶ Me mbështetjen e PNUD

⁷ I cituar si një tjetër shqetësim i madh nga vetë punonjësit e intervistuar

⁸ Akademia e Sigurisë ka një bazë të dhënash në të cilën evidentohen të gjitha trajnimet dhe kualifikimet e organizuara për punonjësit e policisë, por në këtë bazë të dhënash nuk evidentohen lëvizjet apo qarkullimi i këtyre punonjësve. Ndonëse shtimi i një informacioni të tillë në këtë bazë të dhënash shihet si i pamundur, të

kryesisht aktivitetet trajnuese për rastet e dhunës në marrdhëniet familjare si dhe funksionimin e Mekanizmit të Referimit. Vetë procesi i vlerësimit mund të shërbejë si një bazë krahasuese (baseline) e domosdoshme për kryerjen e një sërë studimesh të mëtejshme dhe planifikimin e hapave në të ardhmen.

*b) Përgatitja e një moduli trajnimesh të unifikuar e plotësues të kurrikulës së Akademisë së Sigurisë, me fokus kryesor trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare dhe bashkëpunimin efektiv me antarët e tjerë të Mekanizmit të Referimit - modul ky i detyrueshëm për të gjithë Specialistet(ët) për të Miturit dhe Dhunën në Familje dhe Inspektoret(ët) e Krimeve në nivel të Drejtorisë së Policisë së Qarkut, si dhe për Specialistët e Policisë në Zonë dhe Patrullat e Përgjithshme, meqenëse përfshihen në evidentimin e këtyre rasteve. Pjesë plotësuese të këtij moduli duhet të jenë edhe manualet më të fundit të përpiluara në këtë drejtim⁹. Gjithashtu, në këtë modul dhe në trajnimet pasuese duhet të konsiderohet edhe dhënia e informacionit dhe përgatitja e punonjësve të policisë - sidomos inspektorëve apo specialistëve të krimeve - për hetimin e rasteve të formave të ndryshme të dhunës në familje, të tilla si dhuna psikologjike, emocionale, ekonomike, dhuna e përsëritur dhe cikli i dhunës, etj. Fokus të veçantë duhet të zërë edhe *dhuna seksuale* – një formë dhune që ende konsiderohet tabu për t'u denoncuar nëse ndodh mes partnerëve/çiftit. Realizimi i një rekomandimi të tillë është mëse i mundshëm në terma afatshkurtër, pasi aktualisht edhe vetë Akademia e Sigurisë është në procesin e ri-organizimit dhe rishikimit të kurrikulave për shkak të përmirësimit të pozicionit të saj dhe klasifikimit si pjesë e arsimit të lartë¹⁰. Theksimi i nevojës për trajnime specifike në lidhje me dhunën seksuale, identifikimin, hetimin dhe proçedimin e këtyre rasteve kur flitet për marrdhëniet familjare, vjen dhe si detyrim ligjor pas hyrjes në fuqi (1 gusht 2014) të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (ratifikuar nga Shqipëria në shkurt 2013). Nga studimi më i fundit¹¹ mbi shërbimet, standartet dhe përputhshmërinë me zbatimin e kësaj Konvente, del qartësisht nevoja për ndërmarrjen e veprimeve për adresimin e dhunës seksuale. Këto veprime nënkuptojnë si ngritjen e qendrave specifike të shërbimeve për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, ashtu edhe *zgjerimin e njohurive dhe fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve të ndryshëm*, për të adresuar raste të tilla. Pavarësisht se cilët mund të jenë institucionet që iniciojnë apo mbështetin përmirësimin e kurrikulës së Akademisë së Sigurisë për përgatitjen dhe aplikimin e këtij moduli të unifikuar të sugjeruar më sipër, si dhe *përgatitjen e një grupi trajnerësh të çertifikuar për të trajnuar punonjësit e policisë në lidhje me format e ndryshme të dhunës në familje dhe mënyrën e trajtimit deri në zgjidhjen e rasteve*, koordinimi duhet të kryhet detyrimisht nga vetë Drejtoria*

paktën ndërmarrja e një vlerësimi të situatës në lidhje me pozicionet dhe lëvizjet e këtyre personave të trajnuar, mund të ishte një fillim i hartëzimit të nevojave të mëtejshme në këtë drejtim.

⁹ Si psh Manuali “ Si t'i përgjigjemi Dhunës në Familje – me fokus të veçantë Policinë e Shtetit Shqiptar” hartuar në vitin 2013 nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim në kuadër të projektit: “Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme/Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet 2012-2015”

¹⁰ Me ndryshimet e Shkurt 2015

¹¹ Albania Draft Report: “Mapping Violence against Women and Girls Support Services”, prepared by L.Kelly, J.Lovett, M.Kocaqi and supported by Council of Europe and UN Women, June 2015.

e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë së Shtetit Shqiptar. Konsultimi e bashkëpunimi edhe me projekte specifike në lidhje me policinë, siç është p.sh. “SACP- Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme/Policisë së Shtetit Shqiptar për policimin në komunitet” do të shtonte efektivitetin dhe vlerat e kësaj ndërhyrjeje të rekomanduar.

- **Përmirësimi i infrastrukturës** – sidomos në lidhje me ambientet ku trajtohen rastet e dhunës në marrdhëniet familjare është domosdoshmëri. Të dhunuarat(it) shpesh pyeten dhe ndihmohen për procedurat e mëtejshme në ambiente tërësisht të papërshtatshme për to dhe fëmijët e tyre, kështu që del si domosdoshmëri sigurimi i ambienteve me kushte të përshtatshme dhe planifikimi i disa shërbimeve mbështetëse të domosdoshme për rastet emergjente¹². Përmirësimi i infrastrukturës duhet të shihet gjithashtu edhe në drejtim të kompletimit të punonjësve me mjetet kryesore të punës¹³, të domosdoshme për të qenë sa më të shpejtë dhe efektivë në ndërhyrjet që kryejnë e shërbimet që ofrojnë. Po kështu veç pajisjeve e mjeteve logjistike, ka shumë rëndësi edhe plotësimi i nevojave me burime njerëzore. Prandaj duhet të planifikohet me shumë kujdes edhe plotësimi i nevojave - të paktën në nivel të Drejtorisë së Policisë së Qarkut – për emërimin me kohë të plotë të disa profesionistëve të domosdoshëm në trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare, siç mund të jenë p.sh. psikologe gra të specializuara në këto çështje¹⁴. Një rol tepër të rëndësishëm këtu luan dhe duhet të luajë vetë Ministria e Punëve të Brendshme, përmes planifikimit dhe buxhetimit me kujdes dhe përgjegjshmëri të burimeve të nevojshme e të mjaftueshme logjistike, në funksion të Policisë së Shtetit, si dhe negocimit me Ministrinë e Financave e donatorë të ndryshëm për sigurimin e këtyre burimeve.
- **Ekzistenca dhe përmirësimi i efektivitetit të shërbimeve mbështetëse** – Në vijim të rekomandimit të mësipërm, theksohet si domosdoshmëri prania dhe efektiviteti i shërbimeve mbështetëse që duhet të ofrohen nga antarët e tjerë të Mekanizmit të Referimit, sidomos nga Bashkitë dhe Shërbimi Social Shtetëror. Këto shërbime, kryesisht të lidhura me akomodimin dhe trajtimin psiko-emocional janë tepër të nevojshme për vijimin e punës nga ana e punonjësve të policisë: mungesa e tyre çon shpesh në pengesa shumë të mëdha për trajtimin me efektivitet të rasteve dhe mund të bëhet shkak për rikthimin e viktimave/të mbijetuarave sërish në të njëjtin ambient dhune. Përmirësimi i efektivitetit të shërbimeve ekzistuese si dhe zgjerimi i tyre duhet të shoqërohen edhe me procedura specifike lehtësuese në funksion të ndihmës së menjëhershme për viktimat. Kufizimet që mund të ekzistojnë në

¹² Psh. ushqim, veshmbathje për viktimën apo fëmijët, etj. Këto së bashku me nevojën për akomodim në një vend të sigurt duhet të trajtohen edhe si pjesë e shërbimeve mbështetëse të ofruara nga antarët e tjerë të MKR.

¹³ Këtu mund të flitet që nga sigurimi i mjeteve dhe lëndës bazë për të ndërhyrë e kryer procedurat paraprake (makina, karburant, kompjutera, bazë materiale ndihmëse për përpilimin e akteve) deri tek pajisja me mjetet për ekzaminim e dokumentim të menjëhershëm të rasteve në vendngjarje (setet specifike ekzaminuese, materiale rregjistruese për mbledhjen e provave – të cilat të jenë të vlefshme për proçedimin e mëtejshëm të rasteve, etj)

¹⁴ Të intervistuarat(it) pohojnë se prania e psikologëve për të miturit është mbështetje por nuk mjafton; duhet domosdoshmërisht të shihet mundësia e përfshirjes së psikologeve gra dhe të specializuara në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

ofrimin e shërbimeve specifike¹⁵, por që bien ndesh me standartet ndërkombëtare dhe të drejtat e viktimave, duhet të trajtohen me kujdes e të eliminohen.

- **Dokumentimi, përditësimi dhe shkëmbimi i rregullt i informacionit** – Dokumentimi i rasteve brenda rradhëve të punonjësve të Policisë së Shtetit kryhet rregullisht, sipas procedurave të brendshme të miratuara dhe të dhënat hidhen edhe në sistemin TIMS. Por, sikundër u theksua edhe në pikën (b) të rekomandimit të parë të dhënë në këtë raport vlerësimi, ende ndjehet se nuk funksionon në mënyrën e duhur përditësimi dhe shkëmbimi i informacionit mes antarëve të tjerë të Mekanizmit të Referimit, si për trajtimin e rasteve ashtu edhe për shërbimet ekzistuese e kapacitetet e tyre. Edhe pse i përcaktuar si në VKM 334/2011, edhe në Marrëveshjet e Bashkëpunimit që nënshkruhen nga aktorët (bazuar mbi këtë VKM) për formalizimin e Mekanizmit të Referimit, shkëmbimi i rregullt i informacionit rezulton se nuk ndodh, të paktën pa insistimin e Koordinatorit(es) Vendor(e) - nuk është kthyer ende në një procedurë rutinë për institucionet, sikundër është përcjellja e të njëjtit informacion në institucionet qendrore nga varen. Prandaj rekomandohet edhe një herë përmirësimi i sistemit të shkëmbimit të informacionit ndërmjet këtyre antarëve dhe punonjësve të policisë në nivel të Drejtorisë së Policisë së Qarkut, ku një rol të veçantë duhet të luajë bashkëpunimi mes Koordinatorëve Vendorë në nivel Bashkie dhe Specialistëve për të Miturit dhe Dhunën në Familje që kanë detyrim edhe mbajtjen e statistikave në këtë nivel.
- **Ndërmarrja e hapave të mëtejshëm ligjorë për fuqizimin e pozicionit të punonjësve të policisë në kuadër të trajtimit të rasteve të DHF** – ndonëse më afatgjatë nga pikpamja kohore, marrja e masave në lidhje me rekomandimet e mësipërme si dhe përmirësimi i funksionimit të strukturave të Policisë së Shtetit duke përfshirë dhe zbatimin në praktikë të policimit në komunitet (si një tjetër njësi mbështetëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje) mund të çojë në të ardhmen drejt propozimeve të reja ligjore, të ngjashme me ato të vendeve fqinjë, ku punonjësve të policisë t’u jepet më shumë fuqi veprimi për zbatimin e masave të parashikuara në Ligjin e Dhunës në Familje – p.sh. e drejta për të lëshuar një Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje, i cili më pas të mund të çmohet dhe rivendoset (ose jo) si Urdhër Mbrojtjeje nga Gjykata. Kjo sigurisht që kërkon një vlerësim më të thelluar të

¹⁵ Kufizime që lidhen me kërkesa specifike për ofrimin e shërbimeve p.sh. pajisja e viktimës me UMM si kusht paraprak për t’i ofruar shërbim strehimi – kufizim ky që ndonëse i rishikuar nga ana ligjore ende identifikohet se ekziston në praktikë nga disa ofrues shërbimesh. Ose psh. kryerja e ekzaminimit mjeko-ligjor dhe lëshimi i raportit përkatës vetëm me kërkesën e policisë apo prokurorisë, si dhe dërgimi i këtij raporti vetëm pranë organeve kompetente, pa i lënë mundësinë viktimës të shkojë dhe të ekzaminohet me iniciativën e saj pranë Institucionit të Mjekësisë Ligjore, apo ketë një kopje të raportit të ekzaminimit mjeko-ligjor, si dëshmi e dhunës së pësuar. Kjo procedurë ligjore mund të rishikohet dhe të formulohet më në favor të viktimës dhe dokumentimit të incidenteve të dhunës së pësuar; e drejta e ekzaminimit në strukturat mjeko-ligjore me të njëjtat parime si ekzaminimi dhe kurimi në strukturat e tjera shëndetësore do ta lehtësonte si situatën e viktimës, ashtu edhe mbledhjen e provave. Kuptohet që ndërmarrja e iniciativave të tilla kërkon paraprakisht konsultime më të thelluara me specialistët e fushës, për të identifikuar edhe implikimet në procedura të tjera ligjore e administrative, si dhë mënyrën e adresimit korrekt të tyre.

legjislacionit dhe procedurave aktuale, si dhe ndryshime të kombinuara (në Ligjin për Dhunën në Familje, Kodin e Proçedurës Civile, etj) të cilat paraprakisht duhet të konsultohen dhe me një tryezë shumë më të gjerë aktorësh e ekspertësh të fushës. Pavarësisht se plotësimi i këtij rekomandimi kalon në terma kohorë afatgjatë, sugjerohet që elementë të veçantë lidhur me përmirësimin e efektivitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, të bëhen pjesë e vlerësimeve dhe hapave që po realizohen apo që do vijojnë të ndërmerren në afat të shkurtër kohor. Këtu kemi parasysh psh harmonizimin e legjislacionit nga këndvështrimi gjinor, në përputhje me kërkesat që lindin nga hyrja në fuqi e konventave të ratifikuara (siç është Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje), apo në vijim të konkluzioneve përmbyllëse që pritet të dërgohen nga Komiteti i CEDAW në kuadër të Raportit të IV-rt Periodik Kombëtar për Zbatimin e kësaj Konvente në Shqipëri, etj. Pjesë e këtij harmonizimi mund të bëhet edhe sugjerimi në lidhje me rishikimin e të drejtës së viktimës për të kryer ekzaminimin mjeko-ligjor edhe thjesht me iniciativën e saj (pra jo domosdoshmërisht vetëm me kërkesë të Policisë apo Prokurorisë), si dhe e drejta e saj për të pasur një kopje të raportit mjeko-ligjor (siç u sqarua më në detaje në rekomandimin e mësipërm dhe në footnote 17). Pavarësisht se edhe një raport i thjeshtë mjekësor mbi vizitën që ka kryer viktimë pas incidentit të dhunës, në një nga qendrat e shërbimit spitalor, është detyrim për t'iu dhënë asaj nga mjeku - me qëllim që të shërbejë si provë në lidhje me proçedimin e mëtejshëm për UMM/UM - nga praktika rezulton se në përqindjen më të madhe të rasteve mjekët e përgjithshëm nuk e pajisin viktimën me një raport të vizitës së kryer, duke theksuar se këtë kërkesë mund ta përmbushë vetëm mjeku ligjor. Kjo situatë përforcon rekomandimin e dhënë si për përmirësimin e masave për zbatimin me efektivitet të legjislacionit në fuqi, ashtu edhe për vlerësimin e propozimit për të ndryshuar marrdhënien e viktimës me institucionin e Mjekësisë Ligjore.

II. HYRJE

Ky raport vlerësimi u hartua për t'u ardhur në ndihmë punonjësve të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit Shqiptar për një planifikim sa më efektiv të hapave që duhen ndërmarrë në vijim të Strategjisë së re të Policimit në Komunitet 2015-2017, Ligjit të ri për Policinë e Shtetit, etj dhe është pjesë e një sërë raportesh e studimesh të përpiluara në kuadër të programit SACP - Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj MPB/PSH për policimin në komunitet.

Programi SACP u hartua nga një grup pune i drejtuar nga ISSAT (Grupi Këshillues i Sektorit të Sigurisë Ndërkombëtare) përmes një metodologjie e procesi tërësisht pjesmarrës, si rrjedhojë e një misioni vlerësues fillestar të kryer në këtë kuadër. SACP njeh dhe punon mbi rezultatet e arritura nga programet e mbështetjes së mëparshme dhe atyre në vazhdimësi, si programi i BE-së PAMECA III, si dhe po kontribuon për të përmirësuar drejtimet kryesore të përzgjedhura nga Policia e Shtetit për zbatimin e Strategjisë 7-vjeçare 2007-2013 dhe Planin e Veprimit përkatës. Synim i SACP është të zhvillojë e përmirësojë edhe më tepër programin e Policimit në Komunitet duke përmirësuar aftësinë e Policisë së Shtetit që të ofrojë mbrojtje dhe siguri në përputhje me parimet e shërbimit, si dhe duke rritur besimin e individëve dhe komunitetit e vullnetin e tyre për të bashkëpunuar dhe punuar aktivisht me Policinë e Shtetit, për reduktimin e krimeve.

Programi SACP siguron mbështetje në tre drejtime:

1. Menaxhimi i performancës
2. Partneriteti /bashkëpunimi mes të rinjve dhe policisë, dhe
3. Dhuna në familje.

Ky raport vlerësimi është pjesë e drejtimit të tretë të mbështetjes së ofruar nga SACP dhe është konturuar sipas parimeve të kësaj mbështetjeje, duke respektuar veçanërisht të qenit i mirëfokusuar dhe plotësues në përpjekjet e bëra edhe nga donatorë e organizata të tjera ndërkombëtare.

Fokusi kryesor është roli i policisë në trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare në kontekstin e filozofisë së policimit në komunitet, si dhe roli i saj si një nga antaret kryesore të Mekanizmit të Referimit të ngritur për këtë qëllim. Raporti vjen gjithashtu edhe si pjesë plotësuese e një sërë studimesh paraprake të kryera nga SACP - Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj MPB/PSH për policimin në komunitet¹⁶ apo edhe në vijim të disa vlerësimeve të realizuara nga aktorë të tjerë po në këtë drejtim¹⁷.

Vlera e tij e shtuar qëndron pikërisht në eksplorimin e situatës brenda strukturave të Policisë së Shtetit dhe evidentimin e nevojave për përmirësimin e bashkëpunimit me

¹⁶ Të tilla si: "Studim për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale" realizuar nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Shtator 2013; "Raport i Studimit Bazë mbi Dhunën në Familje dhe Policinë e Shtetit Shqiptar", realizuar nga Instituti Studimor Data Centrum, Tetor 2012; etj.

¹⁷ Të tilla si: vlerësimi i kryer nga IOM për sinergjinë mes mekanizmit kundër dhunës në familje dhe atij kundër trafikimit të qenieve njerëzore (Draft raporti Prill 2015), apo vlerësimi i realizuar nga PNUD për efektivitetin e MKR në nivel vendor (Draft raporti Maj 2015), etj.

antarët e tjerë të Mekanizmit të Referimit, parë nga këndvështrimi i vetë punonjësve të policisë dhe gërshetuar edhe me filozofinë e policimit në komunitet.

Po kështu, informacioni është mbledhur kryesisht në rrethet më pak të analizuara nga vlerësimet e tjera të përmendura më sipër dhe të realizuara gjatë vitit 2015, qëllimisht për të plotësuar më tej panoramën e situatës në lidhje me trajtimin me efektivitet të rasteve të dhunës në familje. Të dhënat e ndryshme statistikore e përshkruese të nxjerra nga rishikimi i literaturës ekzistuese shërbyen si bazë për hartimin e mjeteve të mbledhjes së informacionit të mëtejshëm, si dhe përpunimit e analizës së tij, në funksion të këtij vlerësimi.

III. METODOLOGJIA

Metodat e përdorura për realizimin e vlerësimit janë kryesisht cilësore, mbledhja e informacionit u krye përmes intervistave të thelluara dhe grupeve të fokusuar. Kuptohet që një vend i rëndësishëm iu la edhe mbledhjes së informacionit përmes studimeve e raporteve vlerësuese ekzistuese, si edhe dokumentacionit tjetër ligjor apo politikave të lidhura me objektin e vlerësimit tonë.

Intervistat e thelluara dhe grupet e fokusuar u kryen në Tiranë, Shkodër dhe Elbasan. Përzgjedhja e rretheve u bë duke pasur parasysh disa kritere, si në vijim:

- Ekzistenca e Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare;
- Numri i lartë i rasteve të dhunës në familje të denoncuara, duke synuar të mbulohej si veriu edhe jugu, por duke shmangur qytetet e përfshira në vlerësimin e efektivitetit të funksionimit të Mekanizmit të Referimit, realizuar gjatë këtij viti nga PNUD. Kështu, bazuar në të dhënat e vitit 2014, Elbasani renditet si qyeti i katërt me numrin më të lartë të denoncimeve për rastet e dhunës në marrdhëniet familjare (pas Tiranës, Durrësit e Korçës, por Durrësi e Korça ishin të përfshira në vlerësimin e kryer nga PNUD). Po kështu Shkodra renditet e nënta në rradhë (pas Fierit, Beratit, Lezhës e Vlorës, por Fieri, Lezha e Vlora ishin gjithashtu pjesë e vlerësimit, ndërkohë që Berati u shmang, me qëllim pasjen e një informacioni edhe nga pjesa veriore e Shqipërisë).
- Koston dhe afatet kohore për kryerjen e vlerësimit.

Në total informacioni u mblodh nga 42 profesionistë (10 gra), përmes realizimit të 17 intervistave të thelluara, me përfaqësues(e) të institucioneve të ndryshme¹⁸, antarë të Mekanizmit të Referimit në rrethet e përzgjedhura, si dhe 3 grupeve të fokusuar me punonjës(e) të policisë në Tiranë, Shkodër dhe Elbasan¹⁹. Intervistat e thelluara patën një kohëzgjatje nga 60 – 80 minuta, ndërsa grupet e fokusuar 120 minuta. Instrumentat e përdorur në të dyja rastet u miratuan paraprakisht nga përfaqësues të SACP²⁰.

Gjetjet nga përpunimi i informacionit iu nënshtruan vlerësimit nga ana e grupit konsultues si dhe nga përfaqësues(e) të Policisë së Shtetit dhe SACP. Të gjitha sugjerimet dhe rekomandimet u pasqyruan në mënyrë korrekte në draftin e raportit të vlerësimit, i cili mori formën përfundimtare të tij në fund të muajit korrik 2015.

¹⁸ z. Arben Lloja – Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë, znj. Aida Shehu – Bashkia Tiranë, znj. Silvana Alimadhi, znj. Blerina Bajollari – Drejtorja e Përgjithshme e Policisë Tiranë, z. Krenar Veizi – Komisarati i Policisë nr. 6 Tiranë, znj. Fatbardha Hoxhalli – Qendra Pritëse për Viktimat e Dhunës në Familje Tiranë, znj. Migena Selfollari - Qendra Komunitare “Sot për të Ardhmen”, Tiranë, z. Ilirjan Mandro – Akademia e Sigurisë Tiranë, z. Frederik Laloshi – Prokuroria Shkodër, z. Arben Zefi dhe znj. Ermira Dedja – Gjykata e Rrethit Shkodër, z. Dedë Gazuli – Drejtorja e Policisë Qarkut Shkodër, znj. Jeta Xhabija – Bashkia Shkodër, z. Eugen Beci – Prokuroria Elbasan, znj. Daniela Shirka – Gjykata e Rrethit Elbasan, znj. Fatbardha Menalla – Drejtorja e Policisë së Qarkut Elbasan, znj. Marsida Sejдини – Bashkia Elbasan.

¹⁹ Lista e detajuar bashkëlidhur këtij raporti si aneks VII/1.

²⁰ Formati i instrumentave bashkëlidhur këti raporti si aneks VII/2

Ndonëse i strukturuar qartë sipas qëllimit për të cilin u realizua, ky vlerësim ka edhe disa kufizime të cilat lidhen me:

- *Numrin e vogël të rretheve të targetuara*, për arësyet e shpjeguara më sipër, e për pasojë numrin e kufizuar të opinioneve të mbledhura mes profesionistëve, antarëve të Policisë së Shtetit e Mekanizmit të Referimit.
- *Momentet e zhvillimit nëpër të cilat po kalon vetë Policia e Shtetit*: strategjia e përgatitur dhe struktura e policisë janë ende në proces miratimi dhe ndryshimet që mund të pasojnë miratimin e tyre do të afektojnë sigurisht edhe gjetjet nga ky vlerësim. Riorganizimi i Akademisë së Sigurisë me qëllim përshtatjen e statusit të saj të ri si pjesë e arsimit të lartë në Shqipëri, është një moment tepër favorizues dhe mundëson vënien në jetë të disa rekomandimeve, megjithatë vetë procesi i riorganizimit gjithashtu mund t'i afektojë disa prej këtyre rekomandimeve.
- *Momentet e zhvillimit nëpër të cilat po kalon gjithë pushteti vendor*: ndryshimet që pritet të ndodhin pas zgjedhjeve lokale në njësitë e qeverisjes vendore (reforma e decentralizimit, reforma e administratës publike), të shoqëruara edhe me ndryshimet në shërbimet sociale si pjesë e strategjisë së re të mbrojtjes sociale, apo edhe me shkrirjen e strukturave të Policisë Bashkiake, do afektojnë padyshim edhe vetë mekanizmat e referimit në nivel vendor por edhe shërbimet mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje. Ndonëse realizimi i tyre pritet të sjellë një përmirësim të dukshëm të situatës në lidhje me shërbimet ekzistuese, efektivitetin dhe shtrirjen në mbarë vendin, koha e realizimit të këtyre ndryshimeve deri në stabilizimin e modeleve dhe riorganizimin e plotë të njërive vendore - pasqyruar edhe në Mekanizmin e Referimit - mund të afektojë punën e punonjësve të policisë për trajtimin e rasteve, veçanërisht kur flitet për plotësimin e nevojave emergjente apo edhe afatgjata të viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje.
- *Harmonizimi i kuadrit ligjor dhe reforma e pritur në sistemin e drejtësisë* në kuadër edhe të procesit të integritetit evropian, gjithashtu afekton gjetjet e këtij vlerësimi.
- Së fundi, por jo nga rëndësia, një pjesë e mirë e rekomandimeve të dhëna lidhen drejtpërsëdrejti me *burimet financiare*, ndaj dhe prioriteti me të cilin do t'i shikojë vetë Ministria e Brendshme këto gjetje dhe rekomandime, si dhe aftësia e saj për të lobuar me Ministrinë e Financave apo dhe me donatorë për tërheqjen e burimeve financiare të nevojshme, do ketë ndikim deçiziv në hedhjen e hapave të mëtejshëm, bazuar edhe mbi këtë raport vlerësimi.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, ne besojmë se zhvillimet në muajt në vijim do të jenë tepër pozitive si nga ana e Policisë së Shtetit ashtu edhe nga të gjithë antarët e Mekanizmit të Referimit dhe aktorët e tjerë të interesuar e përfshirë në luftën kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

IV. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë kthyer prej disa vitesh tashmë në një nga prioritetet e shtetit shqiptar për t'u adresuar në mënyrën e duhur dhe me sa më shumë efektivitet, përmes vënies në funksionim edhe të mekanizmave mbështetës e koordinues.

Një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim, që me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 "Për Masa ndaj dhunës në marrdhëniet Familjare" (i ndryshuar) apo dhe në vijim të ndryshimeve e përmirësimit të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (me përfshirjen e dhunës në familje si vepër penale), ka luajtur e vijon të luajë Ministria e Punëve të Brendshme nëpërmjet Policisë së Shtetit Shqiptar. Detajet respektive sa i përket rolit të policisë si antare e Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje jepen në kapitullin V (Analiza e të dhënave) të këtij raporti.

Megjithatë vlen të theksohet se që me hyrjen në fuqi të Ligjit për Dhunën në Familje, janë ndërmarrë një sërë masash që datojnë që herët në vitin 2008, të tilla si: Marrëveshja e Bashkëpunimit për zbatimin e Ligjit Nr.9669 datë 18.12.2006 "Për Masa ndaj Dhunës në Marrdhëniet Familjare", nënshkruar në 14.11.2008 ndërmjet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit; Urdhëri i Ministrit të Brendshëm Nr.379, datë 03.03.2008 "Për Masat që do të ndërmerren nga Policia e Shtetit për Parandalimin dhe Reduktimin e Dhunës në Familje"; Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 981 datë 31.10.2008 "Për Masat që do të ndërmerren nga Policia e Shtetit për Parandalimin dhe Reduktimin e Dhunës në Familje dhe për trajtimin e viktimave të dhunës në familje", etj.

IV/a. Përkufizimi i fenomenit.

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje kanë vite tashmë që janë vënë në fokus të punës së një sërë organizatash e institucionesh publike e private, kombëtare e ndërkombëtare, bashkërendimi i veprimeve të të cilave ka bërë të mundur edhe thyerjen e tabusë dhe ri-orientimin e diskutimit, nga një çështje e "dyerve të mbyllura" në një debat të hapur mes individëve, grupeve, komuniteteve dhe institucioneve e mekanizmave të ndryshëm të ngritur për këtë qëllim.

Të gjitha studimet e kryera evidentojnë faktin se dhuna në familje nuk është dukuri e re në Shqipëri; ajo i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale²¹ (p.sh. rolet dhe identitetet e ngurta gjinore, autoriteti patriarkal, respektimi i kodit të nderit dhe turpit, kontrolli i disa brezave brenda familjes, varfëria, pabarazitë në fushën e arsimit apo punësimit, migrimi si fenomen, etj) që prej kohësh i kanë dhënë formë shoqërisë shqiptare.

²¹ Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojt看 kombëtar me bazë popullatën 2013, fq.9
<http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2013/domestic-violence-in-albania-2013.aspx>

Ndërkohë, siç theksohet edhe në Raportin Kombëtar për Zbatimin e Platformës për Veprim Pekin+20 (Prill 2014): “... Mungesa e një sistemi funksional dhe të mirëkoordinuar parandalimi, trajtimi dhe ri-integrimi të rasteve të dhunës në familje, ka ndikuar shpesh në zgjidhje jo të drejta të situatave, duke theksuar më tepër pabarazitë gjinore. Jo në pak raste, është ndier dukshëm mungesa e besimit të personave që pësojnë dhunë në familje, tek institucionet shtetërore, pikërisht sepse për vite me rradhë dhuna në familje është konsideruar si “çështje e dyerve të mbyllura”. Një pjesë e mirë e grave dhe vajzave detyrohen të jetojnë në marrdhënie të dhunshme për shkak se nuk kanë mbështetje të mjaftueshme përsa i takon aspekteve ekonomike e sociale dhe nuk mund të largohen nga ky mjedis. Pavarësisht masave të shumta të ndërmarra në këtë drejtim (legjislative, administrative, edukative, etj), do të duhet ende kohë që të rifitohet ky besim i humbur e kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet vënies në funksionim të një sistemi sa më eficient dhe të mirëkoordinuar për t’ju përgjigjur në kohë dhe me efektivitet rasteve të paraqitura, si dhe ofrimit të një sërë shërbimesh mbështetëse dhe rehabilituese...”

Përkufizimi i dhunës në familje.

Ekzistojnë një sërë përkufizimesh në lidhje me dhunën në familje, dhunën ndaj gruas, dhunën ndaj fëmijëve, si edhe për të gjithë elementët që lidhen me identifikimin, procedimin, trajtimin e rasteve deri në zgjidhjen e tyre dhe rehabilitimin e riintegrimin e personave të dhunuar. Këto përkufizime janë qartësisht pjesë e legjislacionit tonë kombëtar dhe e një sërë konventash dhe dokumentash ndërkombëtarë të ratifikuar, si dhe janë paraqitur në mënyrë të detajuar edhe në studimet e mëparshme të realizuara nga SACP apo edhe në manualin më të fundit të prodhuar nga ky projekt për dhunën në familje, me fokus policinë e shtetit (të cilat u cituan edhe më sipër). Prandaj duke qenë se këtë vlerësim e konsiderojmë pjesë plotësuese të këtyre materialeve, menduam të shmangim përsëritjen e këtyre përkufizimeve dhe të shtojmë vetëm këndvështrimin sipas Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje²² (Konventa e Stambollit).


*Konventa bazohet në të kuptuarit se dhuna ndaj grave është një formë e dhunës me bazë gjinore që ushtrohet ndaj grave për shkak se ato janë gra (pra për shkak të gjinisë së tyre). Megjithatë shtetet palë të Konventës inkurajohen gjithashtu të aplikojnë një kuadër mbrojtës edhe për burrat, fëmijët dhe të moshuarit, që ekspozohen ndaj dhunës në familje apo brenda njësisë shtëpiake. Është detyrim i shtetit të adresojë plotësisht këtë dhunë në të gjitha format e saj, si dhe të marrë masa për të parandaluar dhunën ndaj grave, për të mbrojtur viktimat e kësaj dhune dhe për të ndëshkuar dhunuesit. Ndërkohë që në nenin e përkufizimeve të kësaj Konvente (neni 3) **“Dhunë në familje”** nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve apo partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve apo partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.*

²² Miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në 7 prill 2011 dhe hyrë në fuqi në 1 gusht 2014.

IV/b. Të dhënat statistikore.

Në nivel kombëtar janë realizuar dy vrojtime të cilat evidentojnë përmasat dhe shtrirjen e fenomenit të dhunës në familje në Shqipëri dhe tentojnë të bëjnë një analizë më të detajuar të shkaqeve dhe pasojave.

Vrojtimi i parë kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje në Shqipëri u krye nga INSTAT në vitin 2007²³, vrotim ky që u pasua edhe nga një i dytë në vitin 2013²⁴. Nga viti 2007 në vitin 2013, përqindja e grave²⁵ që kishin përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës” është rritur nga 56,0% në 59,4%. Nga vrotimi rezultoi se 53,7% e grave po përjetonin “aktualisht” dhunë në familje në vitin 2013. Në vitin 2007, 50,6% e grave kishin përjetuar dhunë emocionale “gjatë jetës” dhe 39,1% kishin përjetuar dhunë psikologjike “gjatë jetës”. Në vitin 2013, 58,2% e grave kishin përjetuar dhunë psikologjike “gjatë jetës”. Nga viti 2007 në vitin 2013, përqindja e grave që kishin pësuar dhunë fizike në familje “gjatë jetës” është ulur nga 31,2% në 23,7%. Nga viti 2007 në vitin 2013, përqindja e grave që kishin përjetuar dhunë seksuale në familje “gjatë jetës” është ulur nga 12,7% në 7,9%²⁶.



Grafiku 1: Krahasimi i disa të dhënave nga vrotimi kombëtar për dhunën në familje për vitet 2007 dhe 2013

Sikurse paraqitet edhe në grafikun nr.1, krahasimi i ndryshimeve në përqindje nga viti 2007 në vitin 2013, na tërheq vëmendjen drejt disa aspekteve të rëndësishme, si:

- *rritja e numrit të rasteve të denoncuara* – kjo tregon një rritje të besimit të publikut në organet përkatëse shtetërore, sidomos në organet e policisë, përderisa këto raste denoncohen tashmë dhe kërkohet ndihmë. Gjithashtu ky tregues thekson edhe një rritje të ndërgjegjësimit se dhuna në familje është krim dhe si i tillë duhet ndëshkuar;

²³ http://www.google.al/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=0CC8QFiAA&url=http%3A%2F%2Fmdhamo.files.wordpress.com%2F2010%2F01%2Fdomestic_violence_robin_final_5_24_09.doc&ei=lxZNU4WnGgTrywPy_IKwBQ&usq=AFQjCNFr_zIHJezx6w1D2LaYXV6b6AGbQ&bvm=bv.64764171,d.bGQ

²⁴ <http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2013/domestic-violence-in-albania-2013.aspx>

²⁵ Kampioni në këtë vrotim kombëtar përbëhej nga gra të moshës 18-55 vjeç

²⁶ Dhuna në familje në Shqipëri: Vrotim kombëtar me bazë popullatën 2013, fq.63.

<http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2013/domestic-violence-in-albania-2013.aspx>

- *ulja e përqindjes së rasteve të dhunës fizike dhe seksuale dhe rritja e përqindjes së rasteve të dhunës psikologjike* - është një tregues që dëshmon se ka një tendencë për ndryshimin e formave të dhunës dhe perceptimit më të gjerë të tyre. Ky tregues na sinjalizon njëkohësisht edhe mbi kujdesin që duhet treguar sa i takon trajtimit të formave të ndryshme të dhunës, *sidomos dhunës seksuale*, pasi kjo formë dhune vazhdon të mbetet ende tabu, e si rezultat edhe statistikat e denoncimit të saj janë në shifra të ulëta - pra si të tilla nuk arrijnë të pasqyrojnë realisht nivelin e kësaj dhune. Ndaj dhe nevojitet një analizë më e detajuar e fenomenit dhe e formave të dhunës apo nivelit të shfaqjes së tyre, të cilat nuk janë objekt i këtij vlerësimi.

Megjithatë nisur nga sa më sipër, duhet evidentuar edhe fakti që pavarësisht rritjes së numrit të denoncimeve, shifrat sërish nuk paraqesin tablonë reale të fenomenit. Sipas Vrojtimit të vitit 2013, gratë e dhunuara shpesh ngurojnë të kërkojnë ndihmë për dhunën në familje. Vetëm 8,4% e grave që kishin përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës” dhe 7,1% e atyre që po përjetonin “aktualisht” dhunë në familje kishin kërkuar ndonjëherë ndihmë për dhunën në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Kjo shifër tregon se shumica e grave të dhunuara në Shqipëri, sidomos në zona të thella rurale, vazhdojnë të vuajnë në heshtje me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin publik për problemet e dhunës në familje dhe shërbimet legislative dhe sociale të krijuara rishtas për mbështetjen dhe trajtimin e këtyre rasteve.

Ndërkohë nga të dhënat e Drejtorisë së Policisë për vitin 2014 rezultojnë një total prej 4,121 rastesh të evidentuara të dhunës në marrëdhëniet familjare, të cilat të ndara sipas qarqeve paraqiten në tabelën në vijim:


Tabela 1: Të dhënat në lidhje me rastet e evidentuara të dhunës në familje për vitin 2014

Drejtoria e Policisë Qarkut													
	Shuma	Tiranë	Durrës	Vlorë	Shkodër	Berat	Fier	Kukës	Dibër	Elbasan	Gjirokastrë	Korçë	Lezhë
Evidentuar	4121	1352	743	164	141	214	251	70	103	283	89	502	210
Kërkesë padi për UMM/UM	2422	778	574	42	73	203	74	32	55	85	67	344	83
Shkelje të UMM/UM	151	48	20	10	10	12	7	3	4	4	3	19	11

Sikurse shihet nga tabela nr.1, nga 4,121 raste të dhunës në familje për vitin 2014 (pra 1,101 raste më shumë se në vitin 2013²⁷), 2,422 raste janë trajtuar me kërkesë - padi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes” (pra 571 raste më shumë se në vitin 2013). Të dëmtuar nga dhuna në familje rezultojnë

²⁷ Gjatë vitit 2013 u evidentuan 3020 raste të dhunës në familje

3,090 gra²⁸ (ose 74.9% të numrit total të viktimave të dhunës) dhe 1,031 burra (ose 24.1%). Bashkëshorte të dëmtuara nga dhuna janë 1798 gra (43.6%). Gjatë vitit 2014 kanë ndodhur 17 krime të vrasjes në familje me 22 viktime, nga të cilat 10 viktime gra/vajza dhe 12 viktime burra/djem (6 autorë të vetvuarë). Krahasuar me vitin 2013²⁹, ka rënie të këtij krimi me 9 raste dhe 6 viktime. Shkaqet e vrasjes kanë qenë për motive të dobta, gjendje depresioni, apo çështje pronësie³⁰.



Grafik 1: Krahasimi i disa të dhënave për rastet e dhunës në familje, sipas statistikave të Policisë së Shtetit

Ndërkohë nëse analizojmë dhe krahasojmë të dhënat e gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 me gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, situata paraqitet si në vijim:

Tabela 2: Të dhënat për gjatë mujorin e parë (Janar-Qershor) për vitin 2014

Drejtoria e Policisë Qarkut													
	Shuma	Tiranë	Durrës	Vlorë	Shkodër	Berat	Fier	Kukës	Dibër	Elbasan	Gjirokastrë	Korçë	Lezhë
Evidentuar	1893	602	329	69	65	103	113	35	46	141	49	256	85
Kërkesë padi për UMM/UM	1147	362	249	20	32	99	45	18	22	38	37	182	43
Shkelje të UMM/UM	64	20	6	1	3	7	6	1	3	1	1	8	7
Procedime penale	769	297	80	23	30	3	70	15	22	67	15	86	61

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2014, janë evidentuar 7 krime të vrasjes në familje.

²⁸ Bashkëshorte, motra, kunata, nëna, bija

²⁹ Gjatë vitit 2013 kanë ndodhur 26 vrasje në familje me 28 viktime,

³⁰ Të dhënat marrë nga Raporti vjetor i Monitorimit të Objektivave të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, për vitin 2014, përgatitur nga MMSR, Mars 2015.

Tabela 3: Të dhënat për gjatë mujorin e parë (Janar-Qershor) për vitin 2015

Drejtoria e Policisë Qarkut													
	Shuma	Tiranë	Durrës	Vlorë	Shkodër	Berat	Fier	Kukës	Dibër	Elbasan	Gjirokastrë	Korçë	Lezhë
Evidentuar	1696	605	307	112	58	102	146	30	23	80	40	151	62
Kërkesë padi për UMM/UM	933	318	242	49	25	62	36	11	11	33	20	103	23
Shkelje të UMM/UM	41	22	7	2	0	2	3	1	0	1	1	2	1

Për vitin 2015, evidentohen 11 vrasje në familje me 12 viktime dhe 3 autorë të vetëvrarë. Lidhja familjare e viktimës me autorin rezulton: (a) bashkëshortja në 4 raste; (b) bashkëshorti në 1 rast; (c) fëmija në 2 raste; (d) prindi në 1 rast; (e) vëllai në 1 rast dhe (f) të tjerë në 3 raste (vjuhërra, djali i xhaxhait, djali i vëllait).

Në kapitujt në vijim jepen më shumë detaje në lidhje me mënyrën e reagimit të punonjësve të policisë sipas specifikave të rasteve (kryesisht veprimet në bazë të shenjave të para të dhunës të evidentuara dhe procedimi me kërkesë padi për UMM/UM apo fillimi i menjëhershëm i ndjekjes penale). Megjithatë, duke qenë se numri i vendimeve të UMM/UM të lëshuara, krahasuar me numrin e UMM/UM të shkelura përbën një tregues përmes të cilit mund të analizohet pjesërisht performanca e punës së punonjësve të policisë në këto raste - sidomos duke pasur në konsideratë filozofinë e policimit në komunitet - po paraqesim shkurtimisht disa të dhëna në këtë drejtim.

Raporti më i fundit “Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin e UMM/UM në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër dhe Sarandë” për periudhën kohore Shtator 2014 – Maj 2015³¹ na prezanton këtë situatë në lidhje me dy nga tre rrethet që janë target i vlerësimit tonë:

- Janë monitoruar gjithsej 103 vendime gjyqësore të lëshimit të UMM/UM në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe 106 vendime gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- Në lidhje me vendimet e pushimit të gjykimit, për çështjet me objekt lëshimin e UMM/UM ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pushimin e gjykimit në 33.9 % të rasteve (në 34.3 % të rasteve për shkak të mosparaqitjes së paditësit/es në seancën gjyqësore dhe në 65.7 % të rasteve është vendosur pushimi i gjykimit për arsye se paditësja/i është paraqitur në seancën gjyqësore dhe ka pohuar para gjykatës se heq dorë nga shqyrtimi i çështjes)

³¹ Përgatitur nga AWEN, financuar nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Objekti	GjRrGj Shkodër	GjRrGj Elbasan
Lëshim i UMM	73	38
Vërtetim i UMM	24	26
Lëshim UM	3	42
Ndërprerja e UM	2	-
Ndryshimi i UM	1	-
Totali	103	106

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur pushimin e gjykimit në 33 % të rasteve (në 51.4 % të rasteve për shkak të mosparaqitjes së paditëses/it dhe në 48.6 % të rasteve për shkak të heqjes dorë të paditëses/it nga gjykimi i çështjes).

Vendimet	GjRrGj Shkodër	GjRrGj Elbasan
Pranim kërkesë	61	49
Pranim i pjesshëm	1	16
Pushim gjykimi	35	35
Rrëzim kërkesë	3	6
Refuzim	3	-
Totali	103	106

- Organi i policisë qëndron në vendin e parë, ndër organet ku viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë denoncuar dhunën e pësuar (rezulton një rritje e besimit të komunitetit, në mënyrë të veçantë viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare tek organi i policisë; ky organ vazhdon të perceptohet nga viktimat si organi që ofron siguri për viktimën e dhunës në familje gjatë procesit gjyqësor të shqyrtimit të kërkesë padisë për lëshimin e UMM/UM dhe ekzekutimit të tij; organi i policisë mundëson prova për dhunën e pësuar nga viktimat duke ia lehtësuar procesin e të provuarit në gjykatë, në çështjet me objekt lëshimin e UMM/UM)
- Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Elbasan ka rezultuar se në 1 % të rasteve policia e ka shoqëruar viktimën në Gjykatë pasi viktimat ka qenë i burgosur, por nuk ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes.

IV/c. Kuadri ligjor.

Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e kuadrit ligjor e institucional kombëtar, si dhe ka ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare që synojnë parandalimin, luftimin dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Hapat e hedhur në këtë drejtim datojnë rreth njëzet vite më parë, por përmirësimet e fokusuara veçanërisht në çështjen e dhunës në familje kulmuan nga viti 2006 e në vijim, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar). Veprime të tjera të rëndësishme ligjore lidhen edhe me:

- Ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
- Ligjin nr.10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”
- Hartimin dhe zbatimin e dy strategjive kombëtare dhe planeve të tyre për veprim, konkretisht: Strategjia e parë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe

kundër Dhunës në Familje (SKBGJ-DHF) 2007-2010³², si dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje (SKBGJ-DHBGJ&DHF) 2011-2015 (e rishikuar) dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj³³. Po kështu i rëndësishëm është edhe “Plani Kombëtar i Veprimit për përfshirjen e burrave/djemve si partnerë të grave/vajzave për arritjen e barazisë gjinore dhe kundër dhunës me bazë gjinore e asaj në familje 2014-2019”, hartuar me kërkesë të MMSR dhe mbështetjen e UNDP, UN Women dhe UNFPA.

- Hartimin dhe zbatimin e VKM Nr. 334 datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij”.
- Parashikimin e dhunës në familje si vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë (me Ligjin Nr.23, datë 01.03.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, si dhe me Ligjin Nr.144/2013 datë 2.5.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”).
- Ndryshimin në Ligjin Nr.10399 datë 17.03.2011 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” ku u sanksionua që t’u jepet ndihmë ekonomike edhe grave të dhunuara, në rastet kur ato pajisen me urdhëra mbrojtës.
- Ligjin Nr. 143/2013 “Për disa shtesa në ligjin Nr 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike” ku u shtua në listën e personave që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmën juridike rastet kur personi është viktimë e dhunës në familje.
- Ratifikimin në shkurt 2013 të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (e njohur gjithashtu edhe si Konventa e Stambollit), e cila ka hyrë në fuqi në datën 1 gusht 2014, etj.

IV.d. Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Përpjekjet për ngritjen e një mekanizmi të tillë kanë filluar menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Dhunën në Familje. Hapat e parë u ndërmorën fillimisht nga OJF-të të cilat të mbështetura nga donatorët ndërtuan modelet e para të pilotimit të këtij mekanizmi në nivel vendor duke u nisur nga zbërthimi i filozofisë së ligjit³⁴. Më pas, po me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare u hartua edhe Platforma Kombëtare për Ndërtimin e Reagimit të Koordinuar të Komunitetit kundër Dhunës në Familje në nivel vendor³⁵, e cila shërbeu si udhërrëfyes për shtrirjen e mekanizmit të pilotuar në të gjithë vendin, duke shtuar edhe elementë pozitivë të praktikës botërore. Për një zbatim sa më të efektshëm të ligjit u hartua dhe miratua edhe VKM Nr. 334 datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij”.

³² Miratuar me VKM nr. 913, datë, 19.12.2007. <http://www.osce.org/albania/32827>

³³ Miratuar me VKM nr. 573, datë 16.6.2011. http://www.dsd.gov.al/previewdoc.php?file_id=1617

³⁴ Projekti i Rrjetit kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit, me titull: “Ta bëjmë Realitet: Zbatimi i Ligjit kundër Dhunës në Familje” - 2007-2009, mbështetur financiarisht nga Fondi i Mirëbesimit i Kombeve të Bashkuara në Përkrahje të Veprimeve për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (UNTF)

³⁵ Në vitin 2009, me mbështetjen e PNUD

Mekanizmi i Referimit është i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme³⁶. Filozofia e këtij mekanizmi është që sapo një viktimë/e mbijetuar kontakton një nga anëtarët e Mekanizmit të Referimit - nuk ka rëndësi se cili anëtar kontaktohet i pari - anëtar i kontaktuar menjëherë fillon procesin mbështetës duke informuar të paktën një përfaqësues të bashkisë, policisë dhe strukturave shëndetësore. Shërbimet e ofruara për viktimën/të mbijetuarën janë afat-shkurtra dhe afat-gjata. Në afat të shkurtër, këto shërbime përfshijnë: mbrojtje të menjëhershme dhe siguri, mbështetje shëndetësore, strehim (duke përfshirë transportin në vend të sigurt), dhe gjithashtu informacion dhe asistencë për fillimin e procedurave për urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes apo për ndjekjen e rastit penalist. Ndërkohë, çështja i referohet edhe institucioneve të tjera në bazë të nevojave të rastit.



Skema 1: Mekanizmi i Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor (skema ideale).

Mbështetja afat-gjatë përfshin referimin tek zyrat e punësimit për mbështetje për punësim, për të marrë ndonjë rekomandim profesional, referimin tek departamenti i shërbimeve sociale për ndihmë ekonomike, strehimin afatgjatë, këshilla ligjore dhe ndihmë në rast se i/e mbijetuara dëshiron të fillojë një procedurë divorci apo një ankesë kundër dhunuesit, këshillim dhe psikoterapi për t'u shëruar nga traumat, por edhe për ri-integrim, si dhe ndihma për fëmijët (dmth. transferimi në një tjetër kopësht ose në shkollë, këshillime/terapi nëse është e nevojshme, etj).

Policia e shtetit konsiderohet si aktori kryesor i këtij mekanizmi: pa bashkëpunimin dhe trajtimin me prioritet e profesionalizëm nga ana e punonjësve të policisë të rasteve të raportuara të dhunës në familje, është thuajse e pamundur të flasim për një Mekanizëm Referimi efektiv.

³⁶ Të tilla si: bashkia, drejtorja e policisë, gjykata, prokuroria, përmbarrimi, qendra shëndetësore, zyra e punësimit, zyra arsimore dhe OJF të specializuara për çështje të DHBGJ dhe DHF.

IV/e. Modeli i policimit në komunitet.

Siç përcaktohet edhe në “Strategjinë e Policimit për Sigurinë në Komunitet 2015-2017”, modeli i policimit në komunitet mbështetet në tre drejtime kryesore:

- *Partneriteti me komunitetin* - Policimi në komunitet bazohet në konceptin që komuniteti/qytetarët duhen “fuqizuar” për të qenë pjesë e zgjidhjes së problemeve të sigurisë. Partneriteti me qytetarët, përmes formave të ndryshme, është promovuesi kryesor i përcaktimit të prioritetëve të punës policore, duke identifikuar shkaqet aktuale dhe potenciale të kriminalitetit dhe konflikteve brenda shoqërisë. Ky partneritet krijon një ndjenjë të përgjegjësisë së përbashkët për adresimin dhe rrugët e zgjidhjes së problemeve dhe shqetësimeve të identifikuara. Policimi efektiv në komunitet përfshin jo vetëm zhvillimin e partneritetit ndërmjet policisë dhe qytetarëve, por edhe bashkëpunimin ndër-institucional me agjensitë shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore.
- *Orientimi i punës së policisë drejt zgjidhjes së shkaqeve, që çënojnë sigurinë në komunitet* - Sipas këtij koncepti puna e policisë duhet të përqendrohet në adresimin e shkaqeve që çojnë në problem dhe çënojnë sigurinë në komunitet apo faktorëve të tjerë stimulues, si një mënyrë efiçente për parandalimin e veprave penale dhe sjelljeve antishoqërore, për rritjen e besimit dhe bashkëpunimit me komunitetin.
- *Transformimi organizativ* - Policimi në komunitet kërkon një transformim organizativ dhe kulturor të vetë Policisë së Shtetit, në mënyrë që një grup vlerash thelbësore të udhëheqin mënyrën e ofrimit të shërbimit ndaj komunitetit. Transformimi organizativ përfshin integrimin e filozofisë së policimit në komunitet në veprimtarinë e PSH, në misionin, politikat, planifikimin dhe procedurat, vlerësimin e performancës, trajnimin, praktikën e rekrutimit dhe zhvillimit të karrierës, në sistemet dhe metodat e policimit që përcaktojnë kulturën organizative dhe veprimtarinë e saj.

Siç del edhe nga përkufizimi i “partneritetit me komunitetin”, policimi në komunitet e ka të parashikuar brenda filozofisë së tij bashkëpunimin ndër-institucional, pra me fjalë të tjera, ky model është lehtësisht i aplikueshëm edhe si pjesë e Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare. Po kështu, përqendrimi i punës së policisë në adresimin e shkaqeve që çojnë në problem dhe çënojnë sigurinë në komunitet, si një mënyrë efiçente për parandalimin e veprave penale, i vjen sërish në ndihmë punës së Mekanizmit të Referimit.

Megjithatë duhet bërë shumë kujdes për moslejimin e transformimit të kësaj pune në “mision pajtimi” për rastet që identifikohen, pasi nuk duhet harruar edhe parimi i “tolerancës zero” për rastet e dhunës së ushtruar në marrdhëniet familjare, paralelisht edhe me parimin e “vendosjes së nevojave të viktimës në qendër të trajtimit të rastit”.

Gjithashtu, zbatimi në praktikë i filozofisë së policimit në komunitet do të ndihmojë shumë dhe në ndryshimin e mentalitetit dhe krijimin e një shoqërie më mbështetëse e mirëkuptuese - veçanërisht në lidhje me mënyrën se si konceptohen, denoncohen e trajtohen rastet e dhunës në marrdhëniet familjare. Të dhënat e deritanishme nga studime të ndryshme, tregojnë se pavarësisht parashikimit në Ligjin për Dhunën në Familje, ku të drejtën e denoncimit të dhunës e ka jo vetëm viktimat por edhe çdo qytetar që konstaton se po ndodh një incident dhune, deri tani këto denoncime rezultojnë se kryhen më së shumti nga vetë viktimat apo të afërmit e tyre.

Ndaj nevojiten shumë më tepër përpjekje të koordinuara për të sfiduar këtë mentalitet e për të mos e konsideruar më dhunën në familje vetëm si “problem i atyre që iu ndodh” por si një shqetësim e problem i gjithë shoqërisë, ku secili(a) të ndiejë dhe zbatojë përgjegjësitë e tij(saj) si qytetar i kësaj shoqërie. Elementë të këtij ndërgjegjësimi duhet të merren në konsideratë në të gjitha hapat që do planifikohen për zbatimin në praktikë të filozofisë së policimit në komunitet, ku kuptohet që rritja e besimit në strukturat e PSH si pasojë e cilësisë dhe efikasitetit të punës së tyre, mbetet primare.

V. ANALIZA E TË DHËNAVE


V/a. Strukturat dhe specialistët e angazhuar në trajtimin e rasteve

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Shtetit ka luajtur e vijon të luajë një rol tepër të rëndësishëm, që prej hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrdhëniet Familjare”, për vetë përgjegjësinë dhe detyrimet me të cilat është ngarkuar nga ky ligj e më gjerë. Siç përshkruhet në Ligj, përgjegjësitë kryesore të Ministrisë së Brendshme përfshijnë: (a) Krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë Drejtorive të Policisë; (b) Trajnimin e efektivave e policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje.

Në zbatim të Ligjit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë Publike, që ka nën varësi, si një nga drejtoritë e saj, edhe Drejtorinë për Krimet ku përfshihet edhe **Sektori për të Miturit dhe Dhunën në Familje**. Ky sektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë (i përbërë nga tre specialistë) përcakton dhe ndjek masat që duhet të marrë Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, bazuar në analizën e situatës sipas të dhënave statistikore që mbledh rregullisht. Po kështu, ky sektor bashkëpunon me sektorë të tjerë në ministritë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Dhunën në Familje, kryesisht për plotësimin e detyrimeve për ndarjen e informacionit statistikor, apo edhe për përgatitjen e raporteve të ndryshme kombëtare.

Në nivel qarku, në Drejtoritë e Policisë, ka një specialist(e), që ndjek dhe koordinon punën e komisariateve të policisë në lidhje me dinamikën e veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje në qark. Specialisti(ja) luan rolin e koordinatorit(es) midis komisariateve dhe informon Sektorin për të Miturit dhe Dhunën në Familje në Drejtorinë për Krimet, në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike. Specialisti(ja) bashkëpunon edhe me organet e pushtetit vendor, prokurorinë, gjykatën, shëndetësinë, arsimin, si dhe me OJF-të që veprojnë në territoret e tyre, për zhvillimin e analizave, takimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta, për të njëjtin qëllim – parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, si dhe trajtimin me efektivitet të rasteve të viktimave/të mbijetuarve të kësaj dhune në shkallë rajoni.

Informacionin e mbledhur nga të intervistuarat(it) dhe pjesmarrëset(it) në grupet e fokusuar, përsa i takon mënyrës se si organizohet puna dhe cilët profesionistë angazhohen në trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare, mund ta paraqesim skematikisht si në vijim:



Pra që në momentin e parë që merret një sinjalizim në lidhje me një incident të dhunës në familje, në vendngjarje drejtohet menjëherë SPZ ose përmes Sallës Operative, Patrulla e Përgjithshme apo edhe ajo e Trafikut Rrugor (cila të jetë më afër), për të parandaluar agravimin e mëtejshëm të situatës, si dhe për të bërë veprimet e para në lidhje me ngjarjen.

Me marrjen e denoncimit, SPZ fillon menjëherë plotësimin e kërkesës për lëshimin e UMM, duke evidentuar në të, të gjitha kërkesat e personit të dëmtuar, sipas rastit dhe nevojës. Nëse konstatohen shenja të dukshme të dhunës fizike, atëhere njoftohet menjëherë Inspektori/Shefi i Krimeve, i cili vjen në vendngjarje dhe fillon procedurat për ndjekjen penalisht të rastit sipas nenit 130/a të Kodit Penal dhe bëhet ndalimi i autorit(es). Po në këtë rrugë ndiqet rasti edhe nëse është i përsëritur.

Në rast se nuk ka dëmtime dhe shenja të dukshme të dhunës fizike, mund të procedohet vetëm me kërkesën për lëshimin e UMM, megjithatë personit të dëmtuar i shpjegohen të gjitha të drejtat që ka. Ndërkohë, pas kryerjes së veprimeve të para dhe pas sigurimit të jetës së personave të përfshirë në incidentin e dhunës, përgatitet dosja me provat përkatëse, për të cilën komunikohet edhe me prokurorinë dhe mjekësinë ligjore dhe dosja e përfunduar dërgohet në gjykatë.

Me marrjen nga Gjykata të vendimit për UMM të lëshuar prej saj, punonjësit e policisë (kryesisht SPZ por edhe inspektori/shefi i krimeve) thërresin të dyja palët dhe u shpjegojnë efektet e vendimit të gjykatës, duke theksuar edhe pasojat në rast të shkeljes së detyrimeve të përcaktuara në UMM. Pas kësaj merren masa për ekzekutimin e vendimit dhe SPZ e mban nën vëzhgim familjen në të cilën ka ndodhur incidenti, për raste të shkeljes së UMM.

Ndërkohë SPZ dhe inspektorët e krimeve kanë detyrim edhe përcjelljen e të dhënave statistikore për rastet e dhunës në familje tek Specialisti(ja) për të Miturit dhe Dhunën në Familje në DPQ. Këta të fundit, i përcjellin të dhënat edhe në Sektorin për të Miturit dhe Dhunën në Familje në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Nga ky sektor, të dhënat raportohen rregullisht në Ministrinë e Brendshme, si dhe në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë apo Mekanizmin e Referimit, sipas kërkesës dhe marrëveshjeve të nënshkruara.




Figura 2: Përcjellja e informacionit statistikor për rastet e dhunës në familje

Ky model reagimi konfirmohet nga punonjësit e policisë në të treja rrethet, pavarësisht burimeve njerëzore dhe infrastrukturore të ndryshme në secilën DPQ.

Pra Mekanizmi i Referimit pret nga Policia e Shtetit që kjo e fundit, si një nga antarët kryesorë të këtij mekanizmi, të ofrojë:

a) shërbimet e duhura për menaxhimin e rastit (të gjitha veprimet që lidhen me hetimin dhe trajtimin e rastit nga momenti i marrjes së denoncimit dhe deri në lëshimin dhe ekzekutimin e UMM, apo procedimin penal);

b) shërbimet parandaluese (mbajtjen nën vëzhgim të familjeve në risk, apo të familjeve ku viktimat është pajisur me UMM për të parandaluar shkeljen e këtij vendimi, diskutimin dhe informimin e komunitetit sidomos të grupeve të veçanta dhe rritjen e besimit të këtyre të fundit tek strukturat e policisë, etj);

c) shkëmbim të informacionit të përditësuar statistikor, me qëllim hedhjen e këtij informacioni në sistemin elektronik të mbledhjes së të dhënave për të analizuar situatën dhe veprimet e ndërmarra, për të monitoruar performancën e çdo institucioni, për të planifikuar në varësi të nevojave dhe prioriteteve, etj.

d) mbështetje për fuqizim të kapaciteteve të antarëve të tjerë – kjo pritshmëri është në terma më afatgjatë dhe kryesisht lidhet me përmirësimin e efektivitetit të vetë antarëve të Mekanizmit të Referimit, që sigurisht pasqyrohet në efektivitetin dhe suksesin e menaxhimit të rasteve, por duket se listohet më larg tre të parave të sipërpërmendura, kur vlerësojmë nevojat sipas skemës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit, që në qendër ka viktimën/të mbijetuarën e DHF.

Vetë Policia e Shtetit, në plotësimin e këtyre pritshmërive angazhon specialistë të strukturave të ndryshme në nivel të parë e të dytë, brenda komisariateve, DPQ-ve dhe vetë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Më konkretisht për çdo pritshmëri/detyrë të listuar më sipër, shohim të angazhohen:

a) shërbimet e duhura për menaxhimin e rastit: Salla Operatore, Patrulla e Përgjithshme, SPZ-të, Inspektori/Shefi i Krimeve.

b) shërbimet parandaluese: SPZ-të, Patrulla e Përgjithshme, Zyra e Shërbimit për Qytetarët, por edhe struktura e Policimit në Komunitet (pas marrjes së vendimit për stabilizimin e një strukture të tillë), pasi elementët parandalues janë pjesë e filozofisë së policimit në komunitet, siç u sqarua edhe në kapitullin III të këtij raporti.

c) shkëmbim të informacionit të përditësuar statistikor: Specialisti(ja) për të Miturit dhe DHF në DPQ, Sektori për të Miturit dhe DHF në DPP.

d) mbështetje për fuqizim të kapaciteteve të antarëve të tjerë: Akademia e Sigurisë, DPP.

Pavarësisht numrit të strukturave që përfshihen në realizimin e pritshmërive të Mekanizmit të Referimit përkundrejt plotësimit të rolit të Policisë së Shtetit si një prej antarëve kryesorë të këtij mekanizmi, është shumë e rëndësishme që vetë Policia e Shtetit të arrijë të sigurojë një mirëkoordinim të këtyre strukturave dhe të ndajë qartësisht edhe nivelin e përfshirjes së tyre në mbledhjet/takimet periodike apo ad hoc të Mekanizmit të Referimit. Kjo duhet reflektuar si në nivel vendim-marrës (mbledhjet e Komitetit Drejtues, ku duhet të përfshihet Drejtori i DPQ) ashtu dhe në nivel të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ku duhet të përfshihet idealisht SPZ dhe inspektori i krimeve që ndjekin rastet, ose në pamundësi të tyre Specialisti(ja) për të

Miturit dhe DHF pranë DPQ. Ky i fundit mban përgjegjësinë edhe për përditësimin e informacionit statistikor). Po kështu ka shumë rëndësi edhe qëndrueshmëria e personave në ndjekjen e këtyre takimeve apo mbledhjeve për menaxhimin e rasteve, si edhe shkëmbimi i rregullt i informacionit nga vetë ata, brenda strukturave të policisë dhe mes kolegëve të tyre.




Figura 3: Zbërthimi i marrdhënies mes Mekanizmit të Referimit dhe Policisë së Shtetit

Informacioni i mbledhur dhe analizuar në vijim, synon të evidentojë aspektet pozitive dhe problemet që ndeshen gjatë bashkëpunimit të antarëve të Mekanizmit të Referimit me Policinë e Shtetit, si edhe situatën në brendësi të strukturave të kësaj të fundit, duke mbajtur në konsideratë skemën siç paraqitet edhe në figurën 3, skemë kjo e ndërtuar bazuar në të gjitha përshkrimet e dhëna nga të intervistuarat(it), në lidhje me marrdhëniet mes Mekanizmit të Referimit dhe Policisë së Shtetit.

Gjetjet nga përpunimi i informacionit janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur, në ndonjë rast të shoqëruar edhe me ilustrim shkëputur nga intervista specifike, për të kuptuar më mirë aspektet e evidentuara.

V/b. Gjetjet nga analiza e të dhënave sipas rretheve.

V/b.1. TIRANË:

V/b.1.1. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me Gjykatën:

- Gjykatat vijojnë të japin vendime kontradiktore në lidhje me UMM/UM, nuk merret fare në konsideratë distanca apo hapësira që ka banesa dhe kjo bëhet shkak për shkelje të një prej pikave të përcaktuara në UMM/UM.

V/b.1.2. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me Prokurorinë:

- Bashkëpunimi me Prokurorinë është i mirë dhe nuk evidentohen probleme në lidhje me ndjekjen e rasteve apo masat e propozuara.

V/b.1.3. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me antarët e MKR:

- Dhuna në familje renditet ndër prioritetet kryesore të punës së policisë, rasti ndiqet deri në fund. Por problem mbetet mungesa e shërbimeve mbështetëse, si për detyrimin që ka policia për t'u përgjigjur kërkesave të viktimave, ashtu edhe përsa u takon shërbimeve mbështetëse që duhet të ofrojnë antarët e tjerë të Mekanizmit të Referimit, kryesisht akomodim, mbështetje psikologjike e ligjore, shërbime për fëmijët, mbështetje për strehim afatgjatë e punësim, ndihmë ekonomike, etj.
- Puna e Mekanizmit të Referimit është thuajse e pandjeshme: antarët nuk i përgjigjen rastit me akomodim të menjëhershëm, shërbimet që ofrojnë nuk janë 24 orëshe, nuk ka kapacitete të mjaftueshme për ofrimin e këtyre shërbimeve, shpesh edhe kontaktet që janë lënë nga institucionet pjesë e Mekanizmit nuk rezultojnë të sakta, nuk përditësohen.
- Zyrat e Përmbarrimit nuk bashkëpunojnë dhe nuk i kryejnë detyrimet e tyre në lidhje me rastet e dhunës në familje, përsa i takon ekzekutimit të UMM/UM, apo ekzekutimit të vendimeve që pasojnë procesin e një zgjidhjeje martese (të tilla si shlyerja e detyrimit ushqimor, ndjekja e zbatimit të takimeve të prindit tjetër me fëmijën, në varësi të vendimit për kujdestarinë, etj) sidomos kur kjo e fundit është pasojë e dhunës në familje.
- Qendrat Shëndetësore së bashku me pushtetin vendor gjithashtu mund të luajnë një rol më të madh, në plotësimin e kërkesave për UMM/UM.

V/b.1.4. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me mentalitetin dhe ndikimin e tij:

- Mentaliteti sigurisht që ka ndryshuar, sepse ka rritje të telefonatave e denoncimeve. Megjithatë, strukturat e policisë në Tiranë mbulojnë edhe zona që kryesisht janë të populluara me banorë të ardhur nga rrethet e tjera. Këta banorë shpesh kanë një sërë poblemesh sociale të mbartura apo të fituara nga zhvendosja, si dhe pasqyrojnë një kompleksitet qëndrimesh e reagimesh të bazuar në mentalitetin e zonës nga vijnë, që shpesh ka një ndikim shumë të fortë në mënyrën se si sillen e gjykojnë mbi marrdhëniet familjare dhe antarët e familjeve të tyre. Ndaj dhe nuk mund të mjaftohemi me punën e bërë sa i takon ndryshimit të mentalitetit, sërish nevojiten ndërhyrje të shumta në këtë drejtim. Gjithashtu edhe mungesa e shërbimeve të kompletuara e të gërshetuara nga të gjithë antarët e Mekanizmit të

Referimit, ndikon negativisht në mentalitetin dhe qëndrimet që mban komuniteti.

V/b.1.5. Opinioni i aktorëve të tjerë në lidhje me bashkëpunimin me Policinë:

- Bashkëpunimi me policinë është përgjithësisht i mirë, por sërish ka vend për përmirësime.
- Policia duhet të caktojë një person që të ndjekë rregullisht takimet e MKR, megjithëse përgjithësisht këto takime janë ndjekur, por nuk rekomandohet ndryshimi i personave që marrin pjesë në to.
- Policia duhet të bëjë kujdes në orientimin e rasteve drejt Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e DHF – jo çdo rast mund të pranohet dhe trajtohet në këtë qendër.

V/b.1.6. Nevojat e evidentuara:

- Nevojë urgjente për vënien në dispozicion të shërbimeve mbështetëse të lidhura me akomodimin, trajtimin për fëmijët dhe plotësimin e nevojave sociale të menjëhershme të viktimave.
- Funksionimi i Mekanizmit të Referimit me efektivitet dhe përmes ndihmës në zgjidhjen e rasteve, sidomos sa i takon ofrimin të shërbimeve mbështetëse të cilat duhet të jenë 24-orëshe dhe të shtrira në mbarë vendin, me qëllim adresimin e nevojave të menjëhershme dhe afatgjata të viktimave – vetëm organizimi i disa mbledhjeve nuk mjafton për të mbështetur punën e çdo institucioni. Çdo institucion duhet të kryejë me përgjegjshmëri detyrimet e tij në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

“Ndërkohë që policia punon 24 orë çdo ditë të javës, shërbimet e tjera mezi përgjigjen edhe gjatë tetë orarëshit të punës, e jo më pas orarit zyrtar. Por dhuna nuk ndodh në orare fikse, madje orët e pasdites apo të darkës janë ndonjëherë me shumë më tepër fluks. Ku janë shërbimet sociale, po strehëzat e ngritura, po OJF-të??!! – Shef krimesh, Tiranë

- Duhet të vihen në dispozicion burime të mjaftueshme financiare, njerëzore si dhe të plotësohen nevojat për infrastrukturë - ka shumë nevojë për plotësim të kushteve në nivel komisarati, për të kryer punën e përditshme.
- Në nivel komisarati ka nevojë për specialist(e) për të miturit.
- Ka shumë rëndësi edhe fuqizimi i strukturës për DHF, duhet të ketë specialist(e) në nivel komisarati, të paktën në komisaritet e nivelit të parë dhe të dytë.
- Qëndrueshmëria e punonjësve të policisë është shumë e rëndësishme, sidomos kur flitet për SPZ-të.
- Ka nevojë për një planifikim më të mirë të burimeve njerëzore, që në momentin e ofrimin të mundësive për formim profesional. Një pjesë e mungesës së burimeve njerëzore në strukturat apo rrethet specifike - sot, reflekton pikërisht një planifikim jo të duhur në nivel shkollimi e aftësimi profesional - dje. Kështu p.sh. mungesa e mjekëve ligjorë apo prania e tyre me orare të limituara në mjaft rrethe, nuk vjen si pasojë e mospasjes së numrit të duhur të këtyre profesionistëve, por lidhet me faktin që një pjesë e tyre pas shkollimit refuzojnë të shkojnë në ato rrethe ku ka nevojë (e ndoshta

preferojnë të rrinë edhe pa punë). Ndaj shteti duhet të marrë masa dhe të gjejë mekanizmat e duhur për plotësimin e kësaj mungese në profesionistë, që në momentin e formimit të tyre në bankat e shkollës (marrëveshje detyruese për të pranuar transferimet, sisteme pikëzimi, etj).

- Disa shërbime në funksion të viktimave jepen të kushtëzuara dhe shpesh këto kushte bien në kundërshtim me të drejtat e tyre (p.sh pajisja e viktimës me UMM si kusht për përfitimin e disa shërbimeve të tilla si strehim, ndihmë ekonomike, etj). *Po kështu, ka edhe procedura të përcaktuara ligjërish që privojnë viktimat nga mundësia e pasjes në dorë të provave lidhur me dhunën e ushtruar ndaj tyre (p.sh. ekzaminimi mjeko-ligjor kryhet vetëm me kërkesën e autoriteteve të caktuara dhe raporti i këtij ekzaminimi nuk i dorëzohet viktimës por këtyre autoriteteve).* Praktika të tilla duhet të rishikohen deri në mundësinë e eliminimit të tyre, në funksion të lehtësimit të situatës së viktimave.

“Sigurisht që dhënia e të drejtës direkt personit për të kryer ekzaminimin mjeko-ligjor pa pasur kërkesën e institucioneve specifike, si dhe dorëzimi tek ata i një kopje të raportit të ekzaminimit, do të lehtësonte në shumë raste situatën e viktimave të dhunës, kur bëhet fjalë për mbledhjen e provave për dhunën e ushtruar, sidomos dhunën e përsëritur. Pra ekzaminimi pranë institucionit tonë do kthehej si një procedurë normale ekzaminimi në çdo spital (ku ende sot viktimat nuk pajisen me një kopje të raportit të vizitës së kryer, pavarësisht të drejtës që u jep ligji në këtë rast). Kuptohet që kjo kërkon jo vetëm ndryshime ligjore, por edhe shoqërimin me burimet e nevojshme financiare e njerëzore. Gjithsesi deri në këtë moment që flasim, nuk na rezulton që kryerja e ekzaminimit nga ana jonë të jetë bërë pengesë apo të ketë shkaktuar vonesa, ne reagojmë menjëherë, brenda minimumit të afateve kohore...” – Mjek ligjor, Tiranë

V/b.2. SHKODËR:

V/b.2.1. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me Gjykatën:

- Përgjithësisht ka një bashkëpunim pozitiv dhe Gjykata priret t’i trajtojë me prioritet rastet e dhunës në marrdhëniet familjare. Megjithatë, në disa raste, masat që jep Gjykata nëpërmjet vendimit për UMM e venë në vështirësi policinë, pasi nëse këto masa nuk jepen në përputhje edhe me kushtet ku banojnë familjarët, atëhere urdhëri bëhet i pa zbatueshëm (psh jepet një masë që autori(ja) nuk mund t’i afrohet banesës më shumë sesa 1000 metra, kur distancat në zonën e banimit mund të jenë më të vogla - e kjo masë bëhet e pazbatueshme, ose burim për konflikte të mëtejshme, si pasojë e shkeljes së këtyre distancave). Ose problem shqetësues janë edhe vendimet e zgjidhjeve të martesës në rastet kur familjarët ndajnë sërish të njëjtën banesë.

Vetëm këtë javë kemi pasur dy raste të tilla problematike, është marrë vendimi për zgjidhjen e martesës, por Gjykata i ka lënë në të njëjtin ambient. Familjarët tani i ndajnë ambientet me çarçaf...e si mund ta parandalosh dhunën apo përshkallëzimin e dhunës në këtë rast?! – SPZ, Shkodër

V/b.2.2. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me Prokurorinë:

- Bashkëpunimi me Prokurorinë nuk konsiderohet shumë i efektshëm, punonjësit e policisë ngrenë shqetësimin se prokuroria nuk ka predispozitën e duhur për të arrestuar dhunuesit. Ka mjaft raste kur prokurori nuk vjen në vendngjarje të shikojë viktimën dhe kjo për pasojë sjell vonesa në procedim.

V/b.2.3. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me antarët e MKR:

- Në Shkodër ka një mjek ligjor që është me kohë të pjesshme, por që sa herë është e nevojshme përgjigjet pra marrdhëniet mes dy institucioneve janë të mira dhe nuk ka shqetësime në këtë drejtim.
- Mekanizmi i Referimit funksionon rregullisht, madje Ekipi Teknik Ndërdisciplinar mblidhet edhe ad hoc.
- Ofrimi i shërbimeve mbështetëse është domosdoshmëri.

V/b.2.4. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me mentalitetin dhe ndikimin e tij:

- Mentaliteti mbetet shqetësues, është ky mentalitet që ende i detyron gratë ose të durojnë dhunën dhe mos e denoncojnë atë, ose edhe në rast se e denoncojnë, të tërhiqen më pas, ose të mos duan që të evidentohen se e bënë kallzimin.
- Për shkak të presionit nga shoqëria, shpesh gratë refuzojnë të shkojnë dhe të strehohen në një strehëz, sidomos p.sh. në një rreth tjetër, ato refuzojnë të largohen nga banesa edhe kur Shërbimi Social Shtetëror apo OJF-të e specializuara ua ofrojnë këtë mundësi. Këtu krijohen sërish vështirësi për zbatimin e vendimit të Gjykatës, sidomos kur bëhet fjalë për përcaktimet në UMM/UM. Ndërkohë së shpejti pritet të inagurohet një strehëz në Shkodër e ngritur nga një OJF.
- Është fakt që ka një ndryshim dhe përmirësim të mendimit dhe qëndrimit të komunitetit në lidhje me punonjësit e policisë, ka rritje të telefonatave dhe denoncimeve çfarë tregon rritje të besimit, megjithatë ende nuk mund të thuhet se është arritur në nivelin e ndërgjegjësimit e ndryshimit të dëshiruar. Ndikim pozitiv në këtë drejtim kanë pasur edhe përmirësimet e Kodit Penal.

V/b.2.5. Opinioni i aktorëve të tjerë në lidhje me bashkëpunimin me Policinë.

- Bashkëpunimi i policisë me prokurorinë ekziston dhe vepra penale referohet, por jo në nivelin e duhur profesional. Pra policia i kryen me shpejtësi veprimet e para deri në momentin e përcjelljes së dosjes në Prokurori, më pas nuk i kryen me të njëjtin prioritet veprimet hetimore të detajuara, ose në raste të veçanta dosjet lihen të papërfunduara.
- Duhet të mbahen kontakte të rregullta e të vazhdueshme mes punonjësve të policisë e antarëve të tjerë të Mekanizmit të Referimit, edhe pas kryerjes së veprimeve të para, plotësimit e dërgimit të dosjes në institucionet përkatëse (Prokurori, Gjykatë). Puna e policisë nuk duhet të quhet e përfunduar pas kryerjes së veprimeve të para.
- Policia bashkëpunon ngushtësisht me Bashkinë, si institucion përgjegjës për mirëfunksionimin e Mekanizmit të Referimit. Rastet që përcillen nga bashkia dhe koordinatori vendore trajtohen me prioritet, edhe të dhënat sa herë

kërkohen vihen në dispozicion. Megjithatë ky bashkëpunim duhet përmirësuar në drejtim të përcjelljes së rasteve nga policia në bashki (pra bëhet fjalë për përcjelljen e rasteve që kontaktojnë për herë të parë me policinë).

- Policia duhet t'i ketë të dokumentuara veprimet që kryen me qëllim që t'i verë në dispozicion të Gjykatës kur kërkohet. Gjithashtu policia duhet të marrë iniciativën për të qenë vetë pala paditëse, pra të iniciojë padi publike edhe në rastet kur viktimat e dhunës në familje është e/i rritur.
- Policia duhet të marrë pjesë edhe në veprimet për ekzekutimin e UMM/UM
- Punonjësit e policisë duhet të trajnohen vazhdimisht sidomos për plotësimin e kërkesës për UMM.
- Në lidhje me shërbimet, në funksion të lehtësimit të ekzekutimit të vendimeve, konstatohet e nevojshme edhe ngritja e një qendre akomodimi apo strehëze për dhunuesit³⁷. Po kështu edhe ngritja e programeve të tjera të trajtimit të dhunuesve ka shumë rëndësi.

V/b.2.6. Nevojat e evidentuara:

- Mungesa e burimeve njerëzore, financiare dhe mungesa e infrastrukturës.
- Ka një psikolog në strukturën e DPQ Shkodër, por kryesisht është për të miturit, plus mbulon dhe rastet e trafikimit apo viktimave të mundshme të trafikimit, ndaj nuk mund të thuhet se arrin t'i mbulojë të gjitha nevojat edhe në shqyrtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare.
- Lëvizja/qarkullimi i herë pas hershëm i punonjësve të policisë, sjell probleme në ndjekjen e vazhdueshme të rasteve.

“Lëvizja/qarkullimi i punonjësve ka vërtet efekte negative, mendo: e njeh zonën, identifikon familjet me probleme të mundshme, individët më problematikë, rastet që ke nën UMM/UM e më pas të bie të transferohesh në një zonë tjetër...” – Specialist krimesh, Shkodër

- Të ngrihet një strukturë specifike për trajtimin e dhunës në familje në nivel DPQ dhe të punohet përmes ekipeve, ku të ketë të paktën 1-2 persona në komisarjat dhe në nivel DPQ ky ekip të ketë në përbërjen e tij edhe një specialiste grua. Në nivel DPQ të futet edhe monitorimi veç rakordimit e raportimit të të dhënave.
- Të ofrohen vazhdimisht trajnime për të gjithë punonjësit dhe këto trajnime të jenë specifikisht të fokusuara tek trajtimi i rasteve të dhunës në familje dhe bashkërendimi i veprimeve edhe me antarët e tjerë të Mekanizmit të Referimit.

“Trajnime janë dhënë, por nuk kanë qenë të mirëfillta, problematika e dhunës në familje nuk mund të kalohet me diskutime 2-3 orëshe...” – SPZ, Shkodër

³⁷ Të intervistuarit dhanë informacion edhe për raste që sugjerojnë formulimin e një rekomandimi të tillë, pasi p.sh. janë kushtet e banimit që diktojnë, apo që mund të çojnë në veprime të përshkallëzimit të dhunës: psh në një rast ish bashkëshortja e pajisur me UMM nuk lejonte ish bashkëshortin që të përdorte tualetin.

V/b.3 ELBASAN:

V/b.3.1. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me Gjykatën:

- Bashkëpunimi me gjykatën ka ndryshuar dhe është përmirësuar. Fillimisht nuk shqyrtoheshin dhe ktheheshin në një numër të konsiderueshëm kërkesat për UMM, por tashmë ky problem është zgjidhur.

V/b.3.2. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me Prokurorinë:

- Bashkëpunimi me Prokurorinë është tepër pozitiv, ka një harmonizim dhe mirëkuptim në drejtim p.sh. të masave të kërkuara dhe propozuara.

V/b.3.3. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me antarët e MKR:

- Mekanizmi i Referimit në Elbasan funksionon shumë mirë, mbahen kontakte të rregullta të Policisë me Bashkinë dhe me OJF-të që ofrojnë shërbime.

V/b.3.4. Opinioni i punonjësve të policisë në lidhje me mentalitetin dhe ndikimin e tij:

- Mentaliteti ka ndryshuar, por ende bëhet pengesë p.sh. në rastin e denoncimit të dhunës seksuale.
- Ka hezitime për të filluar punën me dhunuesit.
- Janë bërë disa përpjekje që të fillohet të punohet me djem dhe burra, por ende në një masë të vogël.

V/b.3.5. Opinioni i aktorëve të tjerë në lidhje me bashkëpunimin me Policinë:

- Policia ka një bashkëpunim pozitiv me Gjykatën, megjithatë dosja për rastin duhet të dërgohet prej tyre e plotë dhe jo thjesht me deklarime 3-4 rreshta nga viktima.
- Duhet të trajnohen punonjësit e policisë për plotësimin e kërkesës për UMM/UM. Kërkesat duhet të plotësohen me kompjuter dhe jo me dorë.
- Brenda strukturave të policisë duhet të ketë një sektor të veçantë për dhunën në familje.
- Duhet të shmangen rastet e cënimit të mbrojtjes efektive për shkak të mos mbajtjes kontakt me palët, apo me inspektorët e zonës.
- Duhet të organizohen trajnime të përbashkëta mes gjithë antarëve të Mekanizmit të Referimit
- Ka një bashkëpunim pozitiv të policisë me Prokurorinë dhe Bashkinë, megjithatë gjithmonë ka vend për përmirësim.
- Prania e më shumë punonjësve police gra është e rëndësishme.
- Ka nevojë për trajnim të SPZ dhe patrullave, sidomos në lidhje me komunikimin dhe trajtimin e rastit edhe nga këndvështrimi social, apo evidentimi i rasteve të përsëritura.

V/b.3.6. Nevojat e evidentuara:

- Policia duhet të mbështetet me struktura dhe profesionistë për trajtimin e të miturve, të ketë ambjente në dispozicion për strehim, si dhe psikolog(e) e punonjës(e) social(e).

- Nuk duhet punuar vetëm në drejtim të ndërgjegjësimit të grave për të denoncuar rastet, duhet punuar shumë edhe në lidhje me parandalimin (pra “Mos dhuno!”)
- Duhet punuar shumë me dhunuesit.

“Dënohen dhe sërish dhunojnë, dhunojnë... ky fakt tregon se duhet të punohet shumë me dhunuesit, të kuptohen realisht shkaqet e ushtrimit të dhunës dhe të gjenden mënyrat e duhura për të përcjellë tek ata mesazhet dhe sjelljen kundër dhunës...” – Specialiste krimesh, Librazhd.

- Po kështu, ka shumë rëndësi që punonjësit e policisë të mbajnë kontakte të vazhdueshme me viktimat dhe t’i informojnë ato në kohën e duhur në lidhje me përfundimin e dënimit nga ana e dhunuesit. Do të ishte mirë që PSH në bashkëpunim me antarët e tjerë të Mekanizmit të Referimit të hartonin një plan sigurie për viktimën, gjatë dhe pas periudhës së kryerjes së dënimit nga ana e dhunuesit.
- Mjeku ligjor është i komanduar, kështu që sugjerohet prania e një mjeku ligjor me kohë të plotë, mundësisht pranë DPQ.
- Duhet të vihet në dispozicion një specialist(e) i(e) mirëfilltë që të japë opinionin e tij(saj) për të provuar dhunën psikologjike. Pra siç ekziston mjeku ligjor, të jetë edhe një psikolog(e) i(e) liçensuar që policia të mund t’i drejtohet për të mbledhur provat në rastet e dhunës psikologjike, për të evidentuar elementë specifike p.sh. të përndjekjes, etj.
- Edhe vetë policia ka nevojë për stimul, ngarkesa e rasteve është e madhe. Ka nevojë për shtim personeli dhe ndarje të punës, me qëllim që të shmangen komunikimet e vazhdueshme dhe puna që kryhet edhe pas orarit apo me përfundimin e turnit.

“Edhe punonjësit e policisë janë njerëz me nevojat dhe përgjegjësitë e tyre familjare...nuk mund të jenë gjatë gjithë kohës në punë, kanë familjet e tyre, detyrimet e tyre... Ne edhe pas orarit të punës vazhdojmë të kemi telefonata, na duhet të shkojmë në vend-ngjarje, të punojmë në çdo kohë... E kuptojmë rëndësinë e profesionit që kemi zgjedhur, por duhet të merren masa që edhe puna jonë të lehtësohet dhe të kemi mundësi të çlodhemi e rifitojmë energji, të shtohet personeli, të koordinohen dhe ndahen më mirë përgjigjësitë...” – Specialiste krimesh, Librazhd; SPZ Elbasan

- Ka nevojë për trajnime dhe fuqizim të kapaciteteve të punonjësve.
- Ka nevojë për investim të vazhdueshëm në infrastrukturë, të pajisen punonjësit me kompjutera dhe bazën materiale të nevojshme.

V/c. Opinion i përgjithshëm i punonjësve të policisë mbi riorganizimin e rolit, funksioneve dhe strukturës së policimit në komunitet.

Siç u shpjegua edhe në kapitujt e mëparshëm, veç analizës së situatës në lidhje me pozicionin e Policisë së Shtetit si antare e Mekanizmit të Referimit, ky vlerësim u ndal shkurtimisht edhe në filozofinë e policimit në komunitet dhe transformimin e saj në një strukturë konkrete.

Aplikimi në praktikë i filozofisë së policimit në komunitet dhe rikonceptimi i organizimit të rolit, funksioneve dhe detyrave përkatëse, është një ndër prioritetet e bashkëpunimit të SACP me Ministrinë e Brendshme. Në këtë kuadër është hartuar dhe pritet të miratohet edhe Strategjia e Policimit për Sigurinë në Komunitet 2015 – 2017. Sikundër përshkruhet edhe në këtë dokument strategjik, ka një sërë përpjekjesh të bëra ndër vite që reflektojnë në një formë aplikimin e filozofisë së policimit në komunitet. Kështu, që rreth 18 vite më parë kanë nisur përpjekjet fillestare të organizimit të takimeve në komunitet për qëllime sensibilizimi për çështje të caktuara. Elementë të qartë të kësaj filozofie u përfshinë më konkretisht në ndryshimet si ligjore ashtu edhe strukturore të vitit 2007. Të rëndësishme këtu mund të përmendim:

- a) shërbimin e Patrullës së Përgjithshme, si një shërbim aktiv, pranë komunitetit, i drejtpërdrejtë në kontrollin e territorit dhe me përgjegjësi për parandalimin e krimit.
- b) Shërbimin e ndihmës Specialisti i Policisë në Zonë (SPZ), me detyra kryesore evidentimin dhe trajtimin e konflikteve të ndryshme, bashkëpunimin me komunitetin dhe organet e qeverisjes vendore, mbështetjen e institucioneve publike dhe jo publike në fushën e zbatimit të ligjit, trajtimin e rasteve të dhunës në familje, etj.

Në këtë kuadër, shërbimet bazë të sigurisë në komunitet në nivel operacional janë aktualisht shërbimi i Patrullës së Përgjithshme, shërbimi i SPZ, shërbimi i Policisë Kufitare/Migracionit, dhe shërbimi i Policisë Rrugore. Pika e takimit të tyre me Mekanizmin e Referimit, bazuar edhe në skemën e paraqitur në figurën 3 të seksionit V/a të këtij kapitulli, paraqitet në vijim:




Figura 4: Shërbimet bazë të sigurisë në komunitet dhe lidhja me Mekanizmin e Referimit

Siç shihet edhe nga figura 4, kontaktet më të shumta me komunitetin, në lidhje me rastet e dhunës në familje, i mbajnë drejtpërsëdrejti SPZ-të, të cilët në varësi të rastit bëjnë njoftimet siç janë shpjeguar edhe në kapitujt e mëparshëm të këtij raporti. Nisur nga kjo marrdhënie, transformimi i propozuar i SPZ-ve në OPK (Oficerë të Policimit në Komunitet) **nuk dëmton marrdhënien me Mekanizmin e Referimit**. Megjithatë, sikundër citohet edhe në Strategjinë e Policimit për Sigurinë në Komunitet (objektivi 2) *“transformimi organizativ për thellimin e modelit të policimit në komunitet kërkon një qasje të plotë dhe të integruar ndaj të gjitha shërbimeve për të siguruar një shërbim policor unik dhe të plotë për çdo individ, çdo familje dhe çdo komunitet pavarësisht së ku jetojnë ata në territorin e vendit”*.

Nëse përpiqemi të zërthejmë më tej modelin e propozuar në këtë Strategji dhe lidhjen me Mekanizmin e Referimit, rezulton se: *“Policia e Shtetit synon një ri-organizim të mënyrës të mbulimit të territorit në funksion të konceptit të “zonës policore”*. Sipas këtij koncepti territori në juridiksionin e çdo komisarati/stacioni policor do të ndahet në disa zona policore të mirë-përcaktuara në territor. Në çdo zonë do të organizohen dhe funksionojnë shërbimet e Policisë të Shtetit, sipas karakteristikave urbane apo rurale...” (Strategjia e Policimit për Sigurinë në Komunitet, Objektivi Strategjik 2). Në mënyrë skematike kemi paraqitjen në vijim:




Figura 5: Zbërthimi i strukturës së propozuar të policimit në komunitet dhe lidhja e mundshme me MKR

Siç del nga paraqitja skematike, por edhe bazuar në opinionin e të intervistuarve, aplikimi në praktikë i policimit në komunitet me struktura specifike në nivele të ndryshme të PSH, nuk ndikon aspak negativisht në efektivitetin e shërbimeve të ofruara nga PSH si antare e Mekanizmit të Referimit.

VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje janë evidentuar tashmë qartësisht si prioritete të qeverisë shqiptare. Veprimet për reduktimin e fenomenit dhe trajtimin me efektivitet të rasteve po bëhen gjithnjë e më të organizuara dhe mirëkoordinuara institucionalisht.

Legjislacioni është përmirësuar ndjeshëm sidomos vitet e fundit dhe po kështu është plotësuar edhe me masa administrative e politika, strategji apo plane veprimi, zbatimi i të cilave po jep gjithnjë e më tepër rezultat.

Studimi i fenomenit po bëhet në mënyrë periodike e të mirë-organizuar, tashmë ekzistojnë dy vrojtime mbarëkombëtare dhe përshkrimi i situatës nuk bëhet vetëm mbi bazë studimesh sporadike e të kufizuara.

Janë ngritur e funksionojnë mekanizma për trajtimin e përbashkët dhe në mënyrë multi-disiplinare të rasteve të dhunës në familje. Ka vërtet modele pozitive në këtë drejtim, megjithatë janë një sërë faktorësh që ndikojnë, duke përfshirë këtu edhe fuqinë e njësisë të qeverisjes vendore, numrin e institucioneve të pranishme dhe përgjegjshmërinë e shfaqur prej tyre, praninë ose jo të OJF-ve të specializuara, mungesën e infrastrukturës, etj.

Një punë e mirë është bërë edhe në drejtim të sensibilizimit të opinionit publik e rritjes së besimit për denoncimin e rasteve – efektiviteti i këtyre përpjekjeve është reflektuar me rritjen reale të numrit të denoncimeve, megjithatë sërish ka nevojë për ndërhyrje të mëtejshme në lidhje me ndryshimin e mentalitetit. Ka ende forma dhune që konsiderohen tabu e nuk denoncohen (si psh dhuna seksuale mes bashkëshortëve)

Angazhimi dhe përkushtimi i shfaqur tashmë nga një sërë institucionesh dhe organizatash kombëtare e ndërkombëtare, janë tregues të një ndryshimi të qartë të mentalitetit dhe prioriteteve të aktorëve të përfshirë në këtë sfidë. Nga të gjithë eksperiencat e bashkëpunimit të deritanishëm, është evidentuar se asnjë institucion i vetëm nuk mund ta fitojë betejën kundër dhunës në familje. Të gjithë së bashku, pavarësisht vështirësive të ndeshura e burimeve të kufizuara, mund të bëjnë shumë më tepër.

Pavarësisht ndjeshmërisë së treguar në lidhje me fenomenin, sërish mbetet shumë për t'u bërë për adresimin me efektivitet të tij dhe zgjidhjen në terma afatgjatë: ndiehet mungesa e burimeve njerëzore, financiare, infrastrukturës, shërbimeve mbështetëse; nevojitet një koordinim më i mirë dhe më efektiv jo vetëm mes antarëve të mekanizmave, por edhe mes pushtetit qendror e atij vendor; nevojiten programe specifike rehabilituese për dhunuesit, harmonizimi i vazhdueshëm i legjislacionit vendas me atë ndërkombëtar, përmirësimi i standarteve dhe cilësisë së shërbimeve, etj.

Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit, që me hyrjen në fuqi të Ligjit për Dhunën në Familje kanë ndërmarrë një sërë masash për riorganizimin e punës së tyre, për një përgjigje sa më efektive në trajtimin e rasteve të dhunës në mardhëniet familjare. Megjithatë ka ende nevojë për punë të mëtejshme me qëllim arritjen e rezultateve të dëshiruara.

- **Struktura:** Në DPQ Tiranë ekziston një Seksion për të Miturit dhe Dhunën në Familje, ndërsa në DPQ e tjera në vend ka një Specialist(e) për të Miturit dhe DHF, që luan më shumë rol koordinues, raportues e monitorues. Kështu që punën direkte për trajtimin e rasteve e kryejnë më së shumti SPZ-të (të ndihmuar edhe nga Patrulla e Përgjithshme) dhe inspektorët apo specialistët e krimeve. Në këtë kuadër rekomandohet:
 - përmirësimi i strukturës për dhunën në familje dhe shtimi i personelit: të vendoset të paktën nga një specialist(e) në nivel komisarati (të parë dhe të dytë).
 - të shtohet në strukturë edhe psikolog(e) i(e) specializuar për rastet e dhunës në familje.
 - struktura të ketë në përmbajtje të saj të paktën një punonjëse policie grua.
 - Në përshkrimet e punës dhe detyrat që duhet të mbulojnë Specialistët(et) për të Miturit dhe Dhunën në Familje pranë DPQ - si pjesmarrës në mbledhjet e Mekanizmit të Referimit - të shtohet detyra për mbledhjen e ankesave dhe pengesave në lidhje me plotësimin e nevojave të viktimave të DHF dhe përcjelljen e tyre tek Mekanizmi, për përmirësimin e situatës dhe gjetjen e zgjidhjeve afatgjata e të qëndrueshme (në kuadër të monitorimit të performancës së institucioneve)
- **Infrastruktura,** pavarësisht masave të ndërmarra vazhdimisht dhe mbështetjes edhe nga donacione të huaja (si psh në rastin e punës së SACP për ngritje e Zyrave të Shërbimit të Qytetarëve në disa DPQ), sërish le shumë për të dëshiruar. Jo në pak raste mungojnë kushtet për pritjen dhe intervistimin e personave që pësojnë dhunë në familje. Në këtë kuadër, rekomandohet:
 - përmirësimi i menjëhershëm i infrastrukturës (ambjente të përshtatshme e komode për të trajtuar rastet e dhunës në marrdhëniet familjare).
 - plotësimi i kushteve të punonjësve të policisë për të kryer punën e tyre të përditshme (kompjuter dhe bazë materiale, etj).
- **Trajnimi dhe fuqizimi i kapaciteteve** duket se janë aktivitete që nuk janë lënë jashtë vëmendjes, por sërish ka shumë nevojë për ndërhyrje. Në këtë kuadër rekomandohet:
 - hartimi i një moduli/kurrikule specifike për dhunën në familje, në bashkëpunim dhe koordinim me Akademinë e Sigurisë, si dhe përditësimi i kurrikulës ekzistuese.

- ngritja (ose riorganizimi) nga Akademia i një ekipi me trajnerë të specializuar në këtë drejtim (një grup ekspertësh jo vetëm punonjës(e) të Akademisë, por edhe përfaqësues(e) nga institucione e fusha të ndryshme, të specializuar e çertifikuar për ofrimin e këtyre trajnimeve, të cilët të mund të përfshihen në mënyrë të kombinuar në çdo iniciativë për përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve të policisë). Pavarësisht se cilët mund të jenë aktorët që mund të kontribuojnë në përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve të policisë, duhet të ketë koordinim të veprimeve dhe miratim nga Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit. Trajnimet në këtë mënyrë jo vetëm që do të jenë të njohura e akredituara, por do të shkojnë tek grupet dhe personat që kanë nevojë, posaçërisht të harmonizuar edhe me komponentët e strukturës së propozuar të Policimit në Komunitet, si Zyrat e Shërbimeve për Qytetarët, Patrulla e Përgjithshme, Patrulla e Trafikut Rrugor, sallat operative, inspektorët e rendit, inspektorët e krimeve dhe SPZ-të.
 - trajnimi i inspektorëve/specialistëve të krimeve në lidhje me hetimet e formave të tjera të dhunës, përveç asaj fizike, si psh dhunës seksuale.
 - përditësimi i bazës së të dhënave që ekziston në Akademi, për personat e trajnuar dhe trajnimet e përfituara. Nje bazë e tillë të dhënash duhet të ngrihet edhe në nivel DPQ duke i shtuar edhe lëvizjet e personelit të trajnuar.
- **Policimi në komunitet** vlerësohet si filozofi dhe duket se janë hedhur një sërë hapash për ta bërë këtë filozofi pjesë të punës së përditshme. Takimet me komunitetin janë shtuar, besimi është rritur, janë organizuar takime specifike me grupe të caktuara sidomos në shkolla e në mjaft komunitete ndjehet se është bërë afrimi mes policisë dhe komunitetit në masën e duhur. Megjithatë nevojiten ende hapa për t'u hedhur në këtë drejtim dhe për të kaluar nga një drejtim filozofik, tek zbatimi në praktikë dhe ngritja e një strukture specifike për këtë qëllim. Mënyra se si kjo strukturë mund dhe duhet organizuar do të variojë shumë nga kushtet dhe nevojat në çdo komunitet, nga mundësitë dhe burimet në dispozicion, si dhe do jetë në përputhje me të gjitha dokumentat e tjerë të përgatitur për policinë e shtetit (ligji, strategjia, struktura e re e propozuar, etj). Në këtë kuadër rekomandohet:
 - miratimi i Strategjisë së Policimit të Sigurisë në Komunitet 2015 – 2017
 - ri-organizimi dhe strukturimi i filozofisë së policimit në komunitet, siç është përshkruar në strategji
 - krijimi i një lidhjeje të qartë dhe efiçente mes kësaj strukture dhe Mekanizmit të Referimit.
 - **Mekanizmi i Referimit** dhe trajtimin të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor është shumë i rëndësishëm dhe ndihmon në trajtimin me efektivitet të rasteve. Por funksionimi i tij varet nga një sërë faktorësh dhe angazhimi me përgjegjshmëri i të gjithë antarëve është domosdoshmëri. Policia është

ndër antarët kryesorë të Mekanizmit por sukcesi i punës së saj varet shumë edhe nga angazhimi i antarëve të tjerë si dhe shërbimet në dispozicion. Prandaj, mbetet gjithmonë prioritet fuqizimi i mekanizmave ekzistues dhe shtrirja në të gjithë vendin. Kjo do të varet shumë edhe nga vetë Reforma e Administratës Publike, Strategjia e Decentralizimit si edhe gjithë riorganizmi që do të bëhet në nivel vendor (përfshirë dhe shkrirjen e Policisë Bashkiake), apo në drejtim të shërbimeve në kuadër të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale.

- **Shërbimet mbështetëse** janë domosdoshmëri. Pavarësisht ndërhyrjes nga ana e policisë dhe veprimeve të kryera prej saj, mungesa e shërbimeve mbështetëse shkakton problem në ndjekjen dhe zgjidhjen e rasteve të denoncuara. Në këtë kuadër rekomandohet:
 - buxheti i shërbimeve mbështetëse emergjente për viktimat e DHF në nivel DPQ (nevojat imediate për ushqim, veshmbathje, etj)
 - në lidhje me aktorët e tjerë të Mekanizmit të Referimit: shtimi i shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese. Këto shërbime duhet të jenë cilësore, të shtrira në të gjithë vendin, të ofrohen gjatë harkut kohor 24 orësh dhe të plotësohen edhe me shërbimet që synojnë trajtimin në terma afatgjatë (psh punësim, edukim, formim profesional, strehim afatgjatë, etj)
- **Ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit** në lidhje me çështjet e dhunës në familje është tashmë i dukshëm. Megjithatë në kuadër të përmirësimeve të tjera të pritshme si pasojë e reformës në drejtësi, hyrjes në fuqi të Konventës së Stambollit, procesit të integritit evropian, etj mund të shihet si me vlerë edhe rishikimi i pozicionit të punonjësve të policisë në lidhje me lëshimin e UMM dhe dhënia më shumë autoritet në këtë drejtim. Shumica e profesionistëve të pyetur gjatë kryerjes së këtij vlerësimi e konsiderojnë si shumë të rëndësishëm dhe lehtësues për viktimat, kalimin e autoritetit të lëshimit të UMM nga ana e punonjësve të policisë, ndërkohë që vlerësimi dhe lënia e tij në fuqi të mund të mbetet sërish autoriteti i gjykatës. Ky ndryshim shihet i rëndësishëm e me vlerë për vetë shmangien e agravimeve të mëtejshme të situatave në periudhën 24-48 orëshe deri në lëshimin e UMM nga Gjykata. Sigurisht që përpara marrjes së vendimit për një ndryshim të tillë në legjislacion, rekomandohet edhe organizimi i disa tryezave më specifike konsultative me profesionistë të fushës, për të evidentuar tërësinë e ndryshimeve që duhen pasqyruar në legjislacion por edhe për të përpiluar një plan paraprak masash për të siguruar suksesin e këtij ndryshimi dhe aplikimin e tij me efektivitet në praktikë. Ndonëse jo emergjent për t'u adresuar, ky rekomandim mendojmë se duhet të mbahet në konsideratë në terma afatgjatë të ndërhyrjes. Po në kuadër të harmonizimit të legjislacionit e përmirësimit të standarteve, rekomandohet vëmendje më e madhe në drejtim të zbatimit të standarteve të përmirësuara, si dhe ndryshimit të disa procedurave që mund të sjellin lehtësi për viktimat në dokumentimin e rasteve (psh marrdhënia me mjekësinë ligjore)

Përveç sa më sipër, është domosdoshmëri të mbahen në konsideratë edhe disa momente të tjera të rëndësishme të cilat po i rendisim në vijim:

- **Planifikimi i burimeve financiare** është domosdoshmëri dhe Ministria e Brendshme duhet të luajë një rol të rëndësishëm në planifikimin dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare në dispozicion të Policisë së Shtetit, kur bëhet fjalë për adresimin e nevojave për përmirësimin e situatës në lidhje me dhunën në familje.
- **Planifikimi në kohë dhe me hapa të mirëpërcaktuar** është gjithashtu pjesë e suksesit në drejtim të trajtimit të rasteve. Në këtë kuadër bashkëpunimi ndër-institucional luan një rol të rëndësishëm dhe matja e cilësisë së këtij bashkëpunimi duhet bërë në bazë të përcaktimit të treguesve të qartë. Përcaktimi i tyre ka shumë rëndësi dhe duhet shoqëruar me një përkufizim të qartë të mënyrës së matjes (psh çfarë nënkupton në të vërtetë “pozitiv”, “kënaqshëm”, “i mirë”, “i keq”, etj dhe si matet secili prej tyre.)
- **Analiza e punës, monitorimi dhe vlerësimi** duhet të jenë procese periodike e të vazhdueshme dhe të bëhen pjesë e rutinës së punës, me qëllim që të evidentohet në kohë dhe të merren masat e nevojshme për përmirësimin e punës në të ardhmen.

VII. ANEKSE

VII/a. Lista e të intervistuarve dhe pjesmarrësve në fokus grupe

NR	EMËR MBIEMËR	INSTITUCIONI	POZICIONI	RRETHI
1.	Frederik Laloshi	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Shkodër
2.	Arben Zefi	Gjykata e Rrethit	Kryetar	Shkodër
3.	Ermira Dedja	Gjykata e Rrethit	Gjyqtare	Shkodër
4.	Dedë Gazuli	Drejtoria e Policisë Qarkut	Specialist i DHF	Shkodër
5.	Behar Kraja	Drejtoria e Policisë Qarkut	Shef i Krimeve	Shkodër
6.	Bashkim Hoxha	Komisariati i Policisë	Specialist krimesh 1	Shkodër
7.	Ilir Duka	Komisariati i Policisë	Specialist krimesh 2	Shkodër
8.	Faik Latifi	Komisariati i Policisë	SPZ 1	Shkodër
9.	Skënder Pylla	Komisariati i Policisë	SPZ 2	Shkodër
10.	Luigj Vathi	Drejtoria e Policisë Qarkut	Shef i Rendit	Shkodër
11.	Jeta Xhabija	Bashkia	Nëpunëse e BGJ&DHF	Shkodër
12.	Daniela Shirka	Gjykata e Rrethit	Gjyqtare	Elbasan
13.	Eugen Beci	Prokuroria e Rrethit	Prokuror i Rrethit	Elbasan
14.	Fatbardha Menalla	Drejtoria e Policisë së Qarkut	Specialiste e DHF	Elbasan
15.	Sokol Noka	Drejtoria e Policisë së Qarkut	Shef krimesh	Elbasan
16.	Gentian Vercani	Komisariati i Policisë	Specialist Krimesh 1	Elbasan
17.	Bilal Laloshi	Komisariati i Policisë	SPZ 1	Elbasan
18.	Astrit Hoxha	Komisariati i Policisë	SPZ 2	Elbasan
19.	Elona Tafani	Komisariati i Policisë	Specialist krimesh	Librazhd
20.	Marsida Sejdini	Bashkia	Nëpunëse e BGJ&DHF	Elbasan
21.	Arben Lloja	Instituti i Mjeksisë Ligjore	Mjek Ligjor	Tiranë
22.	Ferdinand Mara	Drejtoria e Policisë Qarkut	Shef i Sektorit të Krimeve	Tiranë
23.	Lindita Lushaku	Drejtoria e Policisë Qarkut	Specialist i DHF 1	Tiranë
24.	Elena Hasanago	Drejtoria e Policisë Qarkut	Specialist i DHF 2	Tiranë
25.	Artion Duka	Komisariati i Policisë nr. 1	Shef komisarati	Tiranë

26.	Besie Koshena	Komisariati i Policisë nr. 1	Specialist krimesh	Tiranë
27.	Fatmir Lleshi	Komisariati i Policisë nr. 4	Shef komisarati	Tiranë
28.	Myftar Kalari	Komisariati i Policisë nr. 4	SPZ	Tiranë
29.	Qani Lami	Komisariati i Policisë nr. 6	Shef i Krimeve	Tiranë
30.	Krenar Veizi	Komisariati i Policisë nr. 6	SPZ për zonën rurale	Tiranë
31.	Roven Zeka	Komisariati i Policisë nr. 2	Specialist krimesh	Tiranë
32.	Ahmet Cara	Komisariati i Policisë nr. 2	SPZ	Tiranë
33.	Pashk Gjoni	Komisariati i Policisë nr. 3	SPZ	Tiranë
34.	Sokol Seli	Komisariati i Policisë nr. 5	Specialist krimesh	Tiranë
35.	Qemal Sina	Komisariati i Policisë nr. 5	SPZ	Tiranë
36.	Skënder Beja	Komisariati i Policisë	SPZ	Kavajë
37.	Aida Shehu	Bashkia	Nëpunëse e BGJ&DHF	Tiranë
38.	Migena Selfollari	QK "Sot për të Ardhmen"	Psikologe	Tiranë
39.	Blerina Bajollari	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë		Tiranë
40.	Silvana Alimadhi	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	Specialiste e DHF	Tiranë
41.	Fatbardha Hoxhalli	Qendra Kombëtare Pritëse për viktimat e DHF	Drejtores	Tiranë
42.	Ilirjan Mandro	Fakulteti i Hetimit të Krimeve/Akademia e Sigurisë	Dekan	Tiranë

VII/b. Struktura e intervistës

- Si mund ta përshkruani situatën në lidhje me dhunën në familje në qytetin tuaj? A ka raste, a janë të shumta në numër, a denoncohen ato?
- Cilat janë format më tipike të dhunës në familje me të cilat jeni ndeshur në punën tuaj?
- Si është organizuar institucioni juaj në përgjigje të trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe fenomenit në tërësi? A keni punonjës, sektorë, drejtori apo departamente të veçanta të ngritura për këtë qëllim?
- A ka ndryshuar/Si ka ndryshuar situata dhe perceptimi i punonjësve përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të fundit legislative, lidhur me Kodin Penal?
- A është i ngritur Mekanizmi i Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare në qytetin tuaj? Nëse po, cilët janë antarët e këtij mekanizmi? A funksionon ai? A është efektiv?
- A bashkëpunon institucioni juaj me policinë e shtetit? Ç'mund të na thoni rreth këtij bashkëpunimi? A është ai i efektshëm, a iu përgjigjet në kohë dhe me profesionalizëm policia, në lidhje me trajtimin e rasteve në mënyrë multi-disiplinare?
- A mund të jepni ndonjë sugjerim/rekomandim në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të punës së punonjësve të policisë, si antarë të Mekanizmit të Referimit?
- Po në lidhje me përmirësimin e efektivitetit të vetë Mekanizmit të Referimit?
- A keni dicka tjetër që dëshironi ta ndani me ne (informacion, komente, sugjerime...)?

Pyetje të tjera shtesë, sipas specifikave të profesionistëve dhe institucioneve që përfaqësojnë:

- Çfarë mendimi ka gjykata/prokuroria/mjekësia ligjore/bashkia në lidhje me bashkëpunimin me policinë? Çfarë shikon si pika të dobëta të këtij bashkëpunimi dhe çfarë do sugjeronit për përmirësim në të ardhmen?
- A i zotëron institucioni juaj mjetet dhe kapacitetet e nevojshme për të trajtuar rastet e dhunës në familje?
- A keni kufizime apo boshllëqe që do të dëshironit t'i adresonit?

- Çfarë mendimi keni në lidhje me fuqizimin e rolit të punonjësve të policisë, psh nëpërmjet dhënies së autoritetit për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilët më pas të mund të verifikohen dhe mbeten ose jo në fuqi nga Gjykata e Rrethit?
- A keni kurrikula specifike për përgatitjen e punonjësve të policisë në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare?
- A keni një ekip trajnerësh të specializuar për këtë qëllim?
- A keni nevojë për më shumë aktivitete për fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve të institucionit tuaj?
- Çfarë sugjerimi do të jepnit konkretisht për aplikimin e mëtejshëm të filozofisë së policimit në komunitet?

VII/c. Struktura e fokus grupeve

- Si është e organizuar Policia e Shtetit në lidhje me ofrimin e shërbimeve për rastet që pësojnë dhunë në familje? Si është organizuar konkretisht Drejtoria juaj?
- Cilat janë strukturat e tjera (shtetërore ose jo) me të cilat ju bashkëpunoni për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje?
- A ka mekanizma specifike të ngritur për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe si e shikoni ju ngritjen/funksionimin e tyre?
- A ekziston dhe a funksionon Mekanizmi i Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje në qytetin tuaj? Çfarë informacioni mund të na jepni rreth tij?
- A është Drejtoria juaj pjesë e këtij Mekanizmi?
- Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të bashkëpunimit tuaj me institucionet/ antarët e tjerë të Mekanizmit?
- Çfarë mendoni se do ndikonte në rritjen e efektivitetit të këtij Mekanizmi, veçanërisht në kuadër të punës së institucionit tuaj?
- Sa dhe si mendoni se e zbatoni ju filozofinë e policimit në komunitet kur bëhet fjalë për identifikimin, mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare? A mund të jepni shembuj konkretë?

VIII. BIBLIOGRAFI

- Ligji nr. 9690 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” <http://www.osce.org/albania/30436>
- VKM Nr. 334 datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij”.
- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” <http://www.osce.org/albania/36682>
- Ligji nr.10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” http://www.ilo.org/aids/legislation/WCMS_178702/lang-en/index.htm
- Strategjia e parë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje (SKBGJ-DHF) 2007-2010 <http://www.osce.org/albania/32827>
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje (SKBGJ-DHG/DHF), 2011-2015 (e rishikuar) dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj http://www.dsd.gov.al/previewdoc.php?file_id=1617
- Udhërrëfytyesi për zbatimin e Konventës së KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje – Vlerësim i situatës aktuale dhe i efekteve financiare për zbatimin e Konventës në Shqipëri”, përgatitur me mbështetjen e UN Women, 2013. <http://www.un.org.al/editor-files/file/Roadmap%20%20Costing%20of%20the%20CoE%20Convention.pdf>
- Vrojtimi i parë dhe i dytë kombëtar për Dhunë në Familje në Shqipëri, INSTAT
- http://www.google.al/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=0CC8QFjAA&url=http%3A%2F%2Fmdhamo.files.wordpress.com%2F2010%2F01%2Fdomestic%20violence%20robin%20final%205%2024%2009.doc&ei=lxZNU4WnGqTrywPyIKwBQ&usq=AFQjCNFr_zIHJezx6ë1D2LaYXV6b6AGbQ&bvm=bv.64764171,d.bGQ
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.
- “Platforma Strategjike për Ndërtimin e Reagimit të Koordinuar të Komunitetit kundër Dhunës në Familje në Shqipëri”, një udhëzues i përgatitur nga T. Gentle dhe M. Kocaqi, me mbështetjen e PNUD, 2009.
- Studim për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale, QKGV, 2013
- Manual “Si t’i përgjigjemi dhunës në familje me fokus të veçantë policinë e shtetit shqiptar”, QAGJZH, 2013
- Draft Raporti për Sinergjitë ndërmjet dy Mekanizmave të Referimit, IOM, Prill 2015
- Draft raporti për vlerësimin e funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës në Familje në nivel vendor, UNDP, Maj 2015.
- Strategjia e Policimit për Sigurinë në Komunitet 2015-2017